

Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara

SKK 8 TË ARDHURAT

Pg.		Paragrafët
	STANDARDI KOMBËTAR I KONTABILITETIT NR. 8 – TË ARDHURAT – I PËRMIRËSUAR	
	PËRMBAJTJA	
	OBJEKTIVI DHE BAZA E PËRGATITJES	1-3
	FUSHA E ZBATIMIT	4-5
	PËRKUFIZIMET KRYESORE	6-7
	<u>VLERESIMI NJOHJA E TË ARDHURAVE</u>	8
	<u>MATJA E TË ARDHURAVE</u>	9-13
	IDENTIFIKIMI I <u>VEPRIMTRANSAKSIONIT</u>	14-15
	SHITJA E MALLRAVE <u>DHE E PRODUKTEVE</u>	16-19
	<u>KRYERJA E SHËRBIMEVE</u>	20-43
	<u>Kontratave të shërbimit</u>	20-23
	<u>Kontratave të ndërtimit</u>	24-27
	Metoda e fazës së përfundimituar	28-34
	<u>Kombinimi dhe segmentimi i kontratave të shërbimeve</u>	
	<u>Përcaktimi i volumit të shërbimit të kryer</u>	
	Të ardhurat nga kontratat e shërbimeve <u>dhe të ndërtimit</u>	35-39
	Kostot nga kontratat e shërbimeve <u>dhe të ndërtimit</u>	40-43
	INTERESAT, TË ARDHURAT NGA <u>SHFRYTEZIMI I PRONËS</u> PËR <u>RDORIMI I PRONËS</u> DHE DIVIDENDËT	44-45
	PARAQITJA NË <u>BILANC PASQYRËN E POZICIONIT FINANCIAR</u> DHE NË PASQYRËN E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	46-47
	SHËNIMET SHPJEGUESE	48-49
	DATA E HYRJES NË ZBATIM	50
	KRAHASIMI ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR <u>PËR NJËSITË E VOGLA DHE TË MESME</u>	51

	<p>SHTOJCA 1 – SHEMBUJ</p> <p>BAZA E KONKLUZIONEVE</p> <p>UDHËZUES PËR ZBATIMIN E SKK 8</p>
	OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES
1	Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 8, <i>Të ardhurat</i> (‘SKK 8’ ose ‘Standardi’), nxjerrë dhe miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministria e Financave, është <u>dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëposhtëm të vendosë rregullat e kontabilizimit dhe përshkruajë trajtimin kontabël, paraqitjen në pasqyrat financiare dhe informacionin në shënimet shpjeguese, në lidhje me të ardhurat nga shitja e mallrave, shërbimeve, interesat, dividendët, shfrytëzimi i pronës dhe kontratat e ndërtimit, në pasqyrat financiare shpjegimit për të ardhurat në pasqyrat financiare</u> , të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Shqipërisë. Këto standarde bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimit, të pranuar në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme, të të cilave jepen në Ligjin nr. 9228, ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të <u>ndryshuar</u> , nxjerrë në prill 2004.
2	SKK 8 mbështetet në <u>Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit</u> , SNK 11, <i>Kontratat e ndërtimit</i> dhe SNK 18, <i>Të ardhurat</i> . <u>SKK 8 është ndryshuar për t’u bërë i krahasueshëm me Seksionin 23 – Të ardhurat të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për Njësitë Ekonomike të Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM)</u> . Një tabelë korresponduese e paragrafëve të Standardit me paragrafë të <u>SNRF për NVM-të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar</u> është dhënë në paragrafin 51 Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 8 ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike <u>raportuese</u> duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit (KKK), të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës <u>financiare</u> , ndryshimeve <u>në pozicionin financiar dhe të fluksit të parasë dhe të kapitalit</u> të njësisë ekonomike <u>raportuese</u> , siç kërkohe në nenin 9 të Ligjit nr. 9 228, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të <u>ndryshuar</u> , nxjerrë në prill 2004
3	Pasqyrat financiare do të përgatiten mbi bazën e konceptit të materialitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nuk do të zbatohen për zërat jomaterialë. Parimi i materialitetit përkufizohet dhe sqarohet në paragrafët 40 deri 90 të SKK 1.
	Objektivi i këtij standardi është të përshkruajë trajtimin kontabël, paraqitjen në pasqyrat financiare dhe shënimet shpjeguese, në lidhje me të ardhurat nga shitja e mallrave, shërbimeve, kontratat e ndërtimit, tarifat e shërbimeve, interesi, dividendët dhe nga shfrytëzimi i pronësisë.
	Çështja parësore në kontabilizimin e të ardhurave është përcaktimi se kur do të njihen ato. Ky standard identifikon rrethanat, në të cilat plotësohen kriteret për njohjen e të ardhurave. Ai gjithashtu ofron një udhëzim praktik mbi zbatimin e këtyre kriterëve.
	FUSHA E ZBATIMIT
4	Ky standard zbatohet për kontabilizimin e të ardhurave që vijnë nga veprimet dhe ngjarjet e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> (a) shitja e <u>produkteve dhe</u> mallrave; (b) kryerja e shërbimeve; (c) <u>kontratat e ndërtimit në të cilat njësia ekonomike është ndërtuesi</u>; (d) përdorimi i aktiveve të njësisë ekonomike nga palë të treta, nga ku gjenerohen të ardhura interesi, të ardhura nga shfrytëzimi i pronësisë (rojllti), dhe të ardhura nga dividendët; <u>për kontratat e ndërtimit në pasqyrat financiare të palëve kontraktuese.</u>
	Mallrat përbëhen nga mallrat e prodhuara nga njësia ekonomike raportuese për qëllime shitjeje, ato të blera me qëllim rishitje si, për shembull produkte të blera nga një shitës me pakicë ose tokë, si dhe prona të tjera që mbahen për rishitje.
	Shërbimet përbëhen kryesisht nga shërbime të kryera nga njësia ekonomike raportuese, mbi bazën e një kontrate dhe për një periudhë të caktuar kohe. Kryerja e një shërbimi mund të ndodhë brenda një ose më shumë periudhave kontabël.
	Interesi është një shpenzim që përballohet nga njësia ekonomike për përdorimin e parasë ose ekuivalenteve të saj, si dhe një e ardhur që i takon njësisë ekonomike. Shpenzimet nga shfrytëzimi i pronësisë së palëve të treta (shpenzimet e rojlltisë) janë shpenzime që kanë të bëjnë me përdorimin nga njësia ekonomike e aktiveve afatgjata të palëve të treta, të tilla si patenta, emër tregtar, të drejta të autorit dhe programe kompjuterike (softçare). Dividendët janë shpërndarje e fitimit të zotëruesit e

	instrumenteve të kapitalit (për shembull aksionet).
	Një kontratë ndërtimi mund të nënshkruhet për ndërtimin e një aktivi të vetëm, si për shembull urë, ndërtesë, digë, tubacion, rrugë, anije ose tunel.
5	<p>Ky standard nuk trajton të ardhurat që vijnë nga:</p> <p>(a) marrëveshjet e qirasë financiare (shih SKK 7 <i>Kontabilizimi i qirave</i>);</p> <p>(b) dividendët nga investime në pjesëmarrje dhe njësitë e kontrolluara, të cilët kontabilizohen me metodën e kapitalit <u>neto</u> ose nëpërmjet konsolidimit (shih SKK 14 <i>Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta</i>);</p> <p>(c) ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare ose në vlerën e shitjes së tyre (shih SKK 3 <i>Instrumentet financiare</i>);</p> <p>(d) <u>ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve afatgjata materiale</u> të investuara (<u>shih SKK 5 Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale</u>);</p> <p>(e) <u>njohja dhe ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve biologjike që lidhen me aktivitetin bujqësor dhe njohja e prodhimit bujqësor (shih SKK 13 <i>Aktivitet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare</i>);</u></p> <p>(f) <u>kontratat e sigurimit në njësitë ekonomike të sigurimit;</u></p> <p>(g) nxjerrja e pasurive minerale.</p>
	PËRKUFIZIMET KRYESORE
6	<p>Më poshtë jepen përkufizimet e termave kryesore, të përdorura në këtë standard.</p> <p><u>Të ardhurat</u> janë përfitimet ekonomike bruto, të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitalit (këtu nuk përfshihen rritjet, që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital). Burimi kryesor i të ardhurave të një njësie ekonomike është shitja e mallrave dhe kryerja e shërbimeve. Burime të tjera, si interesi, dividendët, dhe rojelltitë dhe grantet qeveritare përbëjnë një element tjetër të të ardhurave.</p> <p><u>Produkte</u> janë të mira të prodhuara nga njësia ekonomike me qëllim shitje.</p> <p><u>Mallra</u> janë të mira të blera nga njësia ekonomike me qëllim rishitje. Konsiderohen mallra dhe pronat të cilat mbahen për rishitje.</p> <p><u>E ardhura nga interesi</u> është një e ardhur që i takon njësisë ekonomike për përdorimin e parasë ose ekuivalentëve të saj nga palë të treta.</p> <p><u>E ardhura nga shfrytëzimi i pronësisë nga palë të treta (rojellti)</u> janë të ardhurat që kanë të bëjnë me përdorimin e aktiveve afatgjata jomateriale të njësisë ekonomike nga palë të treta, të tilla si patenta, emri tregtar, të drejta të autorit dhe programe kompjuterike (software).</p> <p><u>Dividendët</u> janë shpërndarje e fitimit tek zotëruesit e instrumenteve të kapitalit (për shembull aksionet).</p> <p>Vlera e drejtë është shuma, me të cilën mund të shkëmbehet një aktiv ose mund të shlyhet një pasiv, ndërmjet palëve të mirinformuara, të vullnetshme e të palidhura me</p>

	<p>njëra-tjetrën.</p> <p><u>Vlera e drejtë është çmimi që do të pranohej për të shitur një aktiv ose që do të paguhej për të transferuar një pasiv, në një transaksion të zakonshëm midis pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes.</u></p> <p><i>Marrëveshja për kryerjen e shërbimeve</i> është një marrëveshje e lidhur mes palëve për kryerjen e një ose një sërë shërbimesh të ndërlidhura.</p> <p><i>Kontrata e ndërtimit</i> është një kontratë e nënshkruar për ndërtimin e një aktivi të caktuar ose disa aktiveve të kombinuara, që janë të ndërlidhura ngushtë ose të ndërvarura midis tyre, përsa u përket projektimit, teknologjisë dhe funksionit, qëllimit final dhe përdorimit të tyre.</p>
7	<p>Të ardhurat përbëhen nga përfitimet ekonomike bruto, të marra nga njësia ekonomike raportuese për llogari të saj. Shumat e mbledhura, në emër të palëve të treta, të tilla si tatimi mbi vlerën e shtuar, nuk janë të ardhura. Në të njëjtën mënyrë, shumat bruto, të mbledhura nga agjencitë dhe marrëveshjet e komisioneve, nuk janë të ardhura, por vetëm komisione të fituara nga këto marrëveshje.</p> <p><u>Një njësi ekonomike duhet të përfshijë në të ardhurat e saj vetëm hyrjet bruto të përfitimeve ekonomike të arkëtuara dhe për t'u arkëtuar për llogari të vet. Një njësi ekonomike duhet të përjashtojë nga të ardhurat të gjitha shumat e mbledhura në emër të palëve të treta të tilla si taksat e shitjes të mallrave dhe shërbimeve dhe tatimin mbi vlerën e shtuar. Në një marrëdhënie ndërmjetësie (agjenci), një njësi ekonomike do të përfshijë në të ardhurat vetëm shumën e komisioneve të saj. Shumat e mbledhura në emër të shogërisë kryesore nuk janë të ardhura për njësinë.</u></p>
	<u>NJOHJA E TË ARDHURAVE</u>
8	<p><u>Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri.</u></p> <p><u>VLERËSIMI I TË ARDHURAVE MATJA E TË ARDHURAVE</u></p>
9	<p>Të ardhurat do të njihen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme.</p> <p><u>Një njësi ekonomike duhet të masë të ardhurat me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.</u></p>
	<p>Shuma e të ardhurave, që rrjedhin nga një transaksion, përcaktohet zakonisht me një marrëveshje mes njësisë ekonomike raportuese dhe blerësit të mallrave ose shërbimeve (ose përdoruesit të aktivitetit). Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara për volumnin e shitur, siç specifikohet në kontratë.</p>
10	<p>Në shumicën e rasteve pagesat bëhen në parë. Kur paratë arkëtohen menjëherë ose do të arkëtohen shumë shpejt, pas kryerjes së transaksionit, të ardhurat nga shitja janë të barabarta me shumën e parave të arkëtuara ose të arkëtueshme.</p>
11	<p>Kur hyrja e mjeteve monetare ose e ekuivalentëve të mjeteve monetare është shtyrë në kohë, dhe rregullimi përbën në fakt një transaksion financiar, vlera e drejtë e shumës është vlera aktuale e të gjitha arkëtimit të ardhshme të përcaktuara, duke përdorur një normë interesi të përcaktuar. Një transaksion financimi lind kur, për shembull, një njësi ekonomike për shitjen e mallrave ofron kredi pa interes për blerësit ose pranon nga blerësi një dëftesë të arkëtueshme me një normë interesi në nivelin e tregut. Norma e interesit e përcaktuar është norma që mund të përcaktohet më qartë mes:</p> <p>(a) normës së përgjithshme të një instrumenti të ngjashëm të një emetuesi me një rankim të ngjashëm kredie, apo</p> <p>(b) një norme interesi që skanton shumën nominale të instrumentit në vlerën aktuale të çmimit të shitjes së mallrave ose shërbimeve.</p> <p><u>Një njësi ekonomike duhet të njohë diferencën në mes vlerës aktuale të të gjitha hyrjeve të ardhshme dhe shumës nominale të të ardhurave nga interesi në përputhje me paragrafët 44 dhe 45 dhe SKK 3.</u></p>
12	<p><u>Një njësi ekonomike nuk do të njohë të ardhura:</u></p>

	<p><u>(a) kur mallrat ose shërbimet janë shkëmbyer për mallra ose shërbime të ngjashme në natyrë dhe vlerë, ose</u></p> <p><u>(b) kur mallrat ose shërbimet janë shkëmbyer për mallra ose shërbime jo të ngjashme, por transaksionit i mungon përmbajtja tregtare.</u></p> <p><u>Kur mallrat ose shërbimet shkëmbehen me mallra dhe shërbime të së njëjtës natyrë dhe vlerë, shkëmbimi nuk konsiderohet si shitje e mallrave apo shërbimeve që gjeneron të ardhura.</u></p>
13	<p><u>Një njësi ekonomike duhet të njohë të ardhurat kur mallrat ose shërbimet e shitura janë shkëmbyer për mallra ose shërbime jo të ngjashme në një transaksion që ka përmbajtje tregtare. Në këtë rast, njësi ekonomike do të masë transaksionin me:</u></p> <p><u>(a) vlerën e drejtë të mallrave ose shërbimeve të marra, e rregulluar për ndonjë shumë të transferuar të mjeteve monetare ose ekuivalentëve të tyre;</u></p> <p><u>(b) nëse shuma në pikën (a) nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, atëherë do të matet me vlerën e drejtë të mallrave ose shërbimeve të dhëna të rregulluar për ndonjë shumë të transferuar të mjeteve monetare ose ekuivalentëve të tyre; ose</u></p> <p><u>(c) nëse vlera e drejtë qoftë e aktivit të marrë, apo e aktivit të dhënë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, atëherë do të matet me vlerën kontabël të aktivit të dhënë të rregulluar për ndonjë shumë të transferuar të mjeteve monetare ose ekuivalentëve të tyre .</u></p> <p><u>Kur mallrat dhe shërbimet shkëmbehen me mallra ose shërbime të ndryshme, atëherë një shkëmbim i tillë do të konsiderohet si shitje e mallrave ose shërbimeve që gjeneron të ardhura. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të mallrave ose shërbimeve të marra, e rregulluar për shumën e parave të arkëtuara ose të paguara. Kur vlera e drejtë e mallrave apo shërbimeve të marra nuk mund të matet me besueshmëri, të ardhurat maten me vlerën e drejtë të mallrave dhe shërbimeve të shkëmbyera, e rregulluar për shumën e parave të arkëtuara ose të paguara.</u></p>
	<p><u>IDENTIFIKIMI I VEPRIMIT TRANSAKSIONIT</u></p>
14	<p><u>Si rregull, të ardhurat njihen veças për çdo transaksion, por në rrethana të caktuara është e nevojshme që të ardhurat të njihen për çdo komponent të ndashëm e të identifikueshëm të transaksionit. Për shembull, kur shitja e një produkti përfshin shërbime të mëpasshme, shuma dhe afati i të cilave përeaktohen në marrëveshje, atëherë e ardhura nga shërbimi njihet si e tillë në kohën kur shërbimi kryhet.</u></p> <p><u>Një njësi ekonomike zakonisht zbaton kriteret e njohjes së të ardhurave për secilin transaksion më vete. Megjithatë, një njësi ekonomike zbaton kriteret e njohjes veças për çdo përbërës të identifikueshëm të një transaksioni të vetëm kur është e nevojshme që të pasqyrohet përmbajtja e transaksionit. Për shembull, një njësi ekonomike zbaton kriteret e njohjes për përbërësit e identifikueshëm veças të një transaksioni të vetëm, kur çmimi i shitjes së një produkti përfshin një shumë të identifikueshme për shërbimin e mëvonshëm. Anasjelltas, një njësi ekonomike zbaton kriteret e njohjes të dy ose më shumë transaksioneve së bashku, kur ata janë të lidhur në mënyrë të tillë që efekti tregtar nuk mund të kuptohet pa iu referuar grupit të transaksioneve si një i vetëm. Për shembull, një njësi ekonomike zbaton kriteret e njohjes të dy ose më shumë transaksioneve së bashku kur shet mallra dhe, në të njëjtën kohë, hyn në një marrëveshje të veçantë për riblerjen e mallrave në një datë të mëvonshme, duke mohuar efektin thelbësor të transaksionit.</u></p>
	<p><u>Në rrethana të caktuara, kur dy ose më shumë transaksione kryhen në mënyrë të tillë që përmbajtja e tyre ekonomike mund të njihet në kontabilitet në mënyrë objektive vetëm bashkërisht, atëherë transaksione të tilla njihen si një transaksion i vetëm. Shembuj të tillë janë:</u></p> <p><u>(a) transaksionet e shitjes dhe të rimarrjes me qira, nëse ky veprim bëhet sipas kushteve të qirasë financiare;</u></p> <p><u>(b) transaksionet e shitjes dhe të riblerjes, në të cilat “shitësi” i mallrave merr përsipër të riblejë mallrat “e shitura” brenda afateve dhe kushteve të caktuara;</u></p> <p><u>(c) shitja e kërkesave të arkëtueshme nëpërmjet faktoringut, kur pjesa më e madhe e rreziqeve mbahet nga “shitësi”.</u></p> <p><u>Duke qenë se të gjitha transaksionet e lartpërmendura janë në thelb veprime financiare (d.m.th. aktive të caktuara përdoren si garanci për huat) dhe jo si veprime</u></p>

	shitblerje, "shitja" e aktiveve nuk regjistrohet. Arkëtimi i parave njihet si detyrim ndaj financuesit.
15	<u>Nganjëherë, si pjesë e një transaksioni shitjeje, një njësi ekonomike u jep blerësve të saj një bonus besnikërie që në të ardhmen të marrin mallra ose shërbime falas ose të përfitojnë zbritje në çmim. Në këtë rast, në përputhje me paragrafin 14, njësi ekonomike do ta trajtojë bonusin si një përbërës të veçantë të identifikueshëm të transaksionit fillestar të shitjes. Njësi ekonomike do të shpërndajë vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar në lidhje me shitjen fillestare midis bonusit dhe përbërësve të tjerë të shitjes. Shuma e shpërndarë tek bonusi do të matet duke iu referuar vlerës së tij të drejtë, d.m.th. shumës me të cilën bonusi mund të shitet veçmas.</u>
	SHITJA E MALLRAVE DHE E PRODUKTEVE
16	Të ardhurat nga shitja e mallrave <u>dhe e produkteve</u> do të njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme: (a) njësi ekonomike raportuese ia ka kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e mallrave <u>dhe produkteve</u> ; (b) njësi ekonomike raportuese nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave <u>dhe te produkteve</u> në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/ <u>produktet</u> e shitura; (c) shumën e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; (d) është e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren nga njësi ekonomike raportuese ; (e) shpenzimet e bëra <u>kostot që kanë ndodhur</u> , ose që do të <u>bëhen ndodhin</u> në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri.
17	<u>Vlerësimi nëse një njësi ekonomike ka transferuar rreziqet dhe përfitimet kryesore lidhur me pronësinë tek blerësi, kërkon një analizë të rrethanave të transaksionit.</u> Në shumicën e rasteve, kalimi i rreziqeve dhe i përfitimeve, në lidhje me pronësinë, tek blerësi, përputhet me kalimin e titullit ligjor (për shembull, në shitjet me pakicë ajo ndodh në kohën e dorëzimit të mallrave/ <u>produkteve</u> tek konsumatoriblerësi ; në rastin e shitjes me dorëzim pjesor, kalimi i titullit ligjor bëhet siç përshkruhet në marrëveshjen e dorëzimit pjesor). Në rrethana të caktuara kalimi i rreziqeve dhe i përfitimeve, që burojnë nga pronësia, nuk ndodh në të njëjtën kohë me kalimin e titullit ligjor.
18	Nëse rreziqet që lidhen me pronësinë nuk i kalojnë blerësit, atëherë të ardhurat nuk njihen, pavarësisht nga fakti nëse titulli ligjor i ka kaluar blerësit apo jo. Shembuj të situatave, ku rreziqet nuk i kanë kaluar blerësit dhe, si rrjedhim, të ardhurat nuk njihen nga shitësinjësia ekonomike , janë: (a) <u>kur njësi ekonomike mbart një detyrim për rezultate jo të kënaqshme, që nuk mbulohet nga garancitë normale.</u> (b) kur arkëtimi i të ardhurave nga një shitje e caktuar është i kushtëzuar nga gjenerimi i të ardhurave nga shitja e mëtejshme e këtyre mallrave <u>apo produkteve</u> nga ana e blerësit; (c) kur mallrat <u>apo produktet</u> transportohen e duhet të montohen, dhe montimi është një pjesë e rëndësishme e kontratës, i cili nuk është kryer akoma nga shitësi; (d) kur blerësi ka të drejtë ta anulojë blerjen, për arsye të përcaktuara në kontratën e shitjes, dhe shitësi është i pasigurt mbi mundësinë e kthimit apo moskthimit të mallit <u>apo produktit</u> .
19	Nëse shitësi-njësia ekonomike mbart vetëm një rrezik të parëndësishëm, që lidhet me pronësinë, atëherë të ardhurat nga shitja njihen, edhe pse titulli ligjor nuk është kaluar. Shembuj të situatave <u>të tilla janë, kur rreziqet e rëndësishme i kanë kaluar blerësit, edhe pse titulli ligjor nuk është transferuar, të ardhurat që njihen nga shitësi janë:</u> (a) blerësi ka të drejtë t'i kthejë mallrat <u>apo produktet</u> gjatë kohës së specifikuar në kontratë, dhe shitësi-njësia ekonomike është në gjendje ta parashikojë mundësinë e kthimit, në bazë të përvojës së mëparshme. Në kohën e shitjes, shitësi-njësia ekonomike i njej të ardhurat nga shitja dhe krijon një provizion për mallrat <u>apo produktet</u> me mundësi reklamimikthimi ; (b) titulli ligjor i mallrave <u>apo produkteve</u> të shitura mbahet nga njësi ekonomike si siguri për arkëtimin e shumës,i kalon blerësit vetëm pasi të jetë kryer pagesa e faturës.
	Të ardhurat dhe shpenzimet, që lidhen me të njëjtin transaksion, njihen në të njëjtën kohë; ky proces quhet zakonisht procesi i përputhjes së të ardhurave me shpenzimet.
	KRYERJA E SHËRBIMEVE
	<u>Kontratat e shërbimit</u> Metoda e fazës së përfunduar

20	<p><u>Kur rezultati i një transaksioni që përfshin ofrimin e një shërbimi mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, një njësi ekonomike do të njohë të ardhurat e lidhura me transaksionin duke iu referuar fazës së përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese (nganjëherë referuar si metoda e përqindjes së përfundimit).</u></p>
21	<p>Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve do të njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit, duke supozuar që rezultati i veprimit (d.m.th. të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin) mund të përlllogaritet me besueshmëri. Rezultati i një transaksioni mund të vlerësohet me besueshmëri kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:</p> <p>(a) shumat e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;</p> <p>(b) <u>është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në njësinë ekonomike arkëtimi i pagesës nga kryerja e shërbimit është i mundur;</u></p> <p>(c) <u>faza e përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese, volumi i kryerjes së shërbimit në datën e bilancit mund të matet me besueshmëri;</u></p> <p>(d) <u>kostot e ndodhura shpenzimet e bëra për shërbimin, si dhe ato që do të ndodhin bëhen për përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri.</u></p>
	<p>Në mënyrë që rezultati i transaksionit të mund të vlerësohet me besueshmëri, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:</p> <p>(a) të ekzistojë një marrëveshje për kryerjen e shërbimit ose një marrëveshje tjetër me klientin ku të përshkruhen:</p> <p>i) të drejtat dhe detyrimet e palës që kryen dhe palës që përfiton shërbimin;</p> <p>ii) pagesa për kryerjen e shërbimit, si dhe mënyra dhe afati i kryerjes së pagesës;</p> <p>(b) të ketë një sistem kontabiliteti që bën të mundur mbajtjen dhe lënien e gjurmëve të besueshme në sistem të të ardhurave dhe shpenzimeve, që lidhen me kryerjen e shërbimeve, sipas projekteve të veçanta.</p>
	<p>Të ardhurat nga kryerja e një shërbimi njihen mbi bazën e metodës së fazës së përfunduar. Sipas kësaj metode, të ardhurat dhe fitimi nga shërbimet njihen në mënyrë përpjesëtimore në të njëjtat periudha kur njihen edhe shpenzimet që lidhen me kryerjen e shërbimeve.</p>
22	<p>Metoda e fazës së përfundimit përshkruhet në paragrafët 28-34. njohja e të ardhurave që rrjedhin nga marrëveshje për kryerjen e shërbimeve përshkruhet në paragrafët 41-45; kontabilizimi i shpenzimeve që lidhen me këtë marrëveshje përshkruhet në paragrafët 46-51.</p>
23	<p><u>Kur shërbimet kryhen përmes një numri të pacaktuar veprimesh gjatë një periudhe kohore të caktuar, një njësi ekonomike i një të ardhurat në bazë lineare përgjatë periudhës së caktuar me përjashtim të rastit kur ka evidencë që metoda të tjera përfaqësojnë më mirë fazën e përfundimit. Kur një veprim i caktuar është shumë më i rëndësishëm se çdo veprim tjetër, njësia ekonomike shtyn njohjen e të ardhurave deri sa veprimi i rëndësishëm të kryhet.</u></p>
	<p>Kur një shërbim kryhet gjatë një periudhe shumë të shkurtër kohe, dhe efekti i ndarjes së të ardhurave në periudha të ndryshme është i parëndësishëm, atëherë të ardhurat njihen menjëherë pas kryerjes së shërbimit.</p>
	<p>Kur rezultati i veprimit që ka të bëjë me kryerjen e shërbimeve nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, njësia ekonomike do të njohë të ardhurat vetëm në masën e shpenzimeve të kryera që janë të rikuperueshme, dhe nuk do të njohë fitim.</p>
	<p>Gjatë fazave të para të një shërbimi, shpesh ndodh që rezultati i tij nuk mund të vlerësohet me besueshmëri. Megjithatë, është e mundur që njësia ekonomike të rikuperojë kostot e këtij shërbimi. Në këto raste, të ardhurat njihen në një shumë të barabartë me kostot që priten të rikuperohen. Meqenëse rezultati i veprimit nuk mund të çmohet me besueshmëri, nuk njihet fitim.</p>
	<p>Kur rezultati i shërbimit nuk mund të vlerësohet me besueshmëri dhe nuk mendohet të jetë i mundur rikuperimi i kostove të shërbimit, atëherë nuk njihen të ardhura dhe kostot njihen si shpenzime.</p>
	<p>Kur kostoja totale e kontratës së shërbimit mendohet t'i tejkalojë të ardhurat prej saj, e tërë humbja e parashikuar do të njihet menjëherë. (Shih shembullin (b) në shtojcën 4.</p>
	<p>Humbja e parashikuar do të njihet e tëra dhe menjëherë pa marrë parasysh:</p> <p>(a) nëse puna ka filluar ose jo;</p> <p>(b) fazën e kryerjes së shërbimit;</p> <p>(c)(a) faktin që nga kontrata të tjera shërbimi priten fitime.</p>

	<p><u>Kombinimi dhe segmentimi i kontratave të shërbimeve</u> <u>Kontratat e ndërtimit</u></p>
24	<p><u>Kur rezultati i një kontrate ndërtimi mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, një njësi ekonomike do të njohë të ardhurat dhe kostot që lidhen me kontratën e ndërtimit si të ardhura dhe shpenzime përkatësisht duke iu referuar fazës së përfundimit të aktivitetit të kontratës në fund të periudhës raportuese (shpesh referohet si metoda e përqindjes së përfundimit). Vlerësimi i besueshëm i rezultatit kërkon vlerësime të besueshme të fazës së përfundimit, kostove të ardhshme dhe arkëtueshmërisë së faturave. Paragrafët 28 dhe 34 japin udhëzime në lidhje me metodën e përqindjes së përfundimit.</u></p>
25	<p><u>Kërkesat e këtij Standardi zakonisht zbatohen veças për çdo kontratë ndërtimi. Megjithatë, në disa rrethana, ky Standard është i nevojshëm të zbatohet për përbërësit e identifikueshëm të një kontrate të vetme ose për një grup kontratash së bashku në mënyrë që të pasqyrojë përmbajtjen e një kontrate ose të një grupi kontratash.</u></p>
26	<p><u>Kur një kontratë mbulon një numër aktivesh, ndërtimi i çdo aktivi do të trajtohet si një kontratë ndërtimi e veçantë kur:</u></p> <p><u>(a) për çdo aktiv janë paraqitur propozime të veçanta;</u> <u>(b) çdo aktiv ka qenë subjekt i negociatave të veçanta, si kontraktori dhe klienti janë në gjendje të pranojnë ose refuzojnë atë pjesë të kontratës që lidhet me çdo aktiv; dhe</u> <u>(c) kostot dhe të ardhurat e çdo aktivi mund të identifikohen.</u></p> <p><u>Kur një kontratë mbulon më shumë se një shërbim, kontabilizimi i të ardhurave dhe i shpenzimeve do të trajtohet si një kontratë më vete, atëherë kur:</u></p> <p><u>(a) janë vendosur çmime të veçanta për çdo shërbim që do të kryhet;</u> <u>(b) gjatë negociatave për çmimin, palët mund të pranonin ose të refuzonin çdonjërin prej shërbimeve, edhe pse ata janë përshkruar nën të njëjtën kontratë;</u> <u>kostot dhe të ardhurat nga çdo shërbim janë të ndashme dhe të identifikueshme.</u></p>
27	<p>Një grup kontratash, qoftë me një klient të vetëm ose me disa klientë, do të trajtohet si një kontratë ndërtimi e vetme kur:</p> <p>(a) grupi i kontratave është negociuar si një paketë e vetme;</p> <p>(b) kontratat janë të ndërlidhura kaq ngushtë saqë, në fakt, ato janë pjesë e një projekti të vetëm me një marzh fitimi të përgjithshëm; dhe</p> <p>(c) kontratat janë kryer njëkohësisht ose në mënyrë të njëpasnjëshme.</p> <p><u>Kur një grup kontratash mbulon një sërë shërbimesh, kontabilizimi i të ardhurave dhe i shpenzimeve do të trajtohet si një kontratë më vete kur:</u></p> <p><u>(a) kontratat janë negociuar dhe lidhur si një paketë e vetme;</u> <u>(b) kontratat janë të ndërlidhura ngushtë dhe mund të konsiderohen si pjesë e të njëjtit projekt;</u> <u>kontratat realizohen njëkohësisht ose në vazhdimësi (d.m.th. njëra pas tjetrës).</u></p>
	<p><u>Metoda e fazës së përfundimit</u></p>
28	<p><u>Kjo metodë përdoret për të njohur të ardhurat nga kryerja e shërbimeve dhe nga kontratat e ndërtimit. Një njësi ekonomike do të shqyrtojë dhe, kur është e nevojshme, rishikojë vlerësimet e të ardhurave dhe kostove kur transaksioni i shërbimit ose kontrata e ndërtimit është në zbatim e sipër.</u></p>
29	<p><u>Volumi i kryerjes së një shërbimi përcaktohet duke përdorur metodat e mëposhtme:</u></p> <p><u>(a) kostot aktuale në përpjesëtim me kostot totale të parashikuara të kontratës për kryerjen e shërbimeve;</u> <u>(b) inspektime të punës së kryer;</u> <u>pjesa e shërbimit të kryer deri në datën e bilancit, si përqindje ndaj totalit të shërbimit që duhet të kryhet (për shembull, sa metra rrugë janë ndërtuar nga totali i parashikuar në kontratë).</u></p> <p><u>Një njësi ekonomike duhet të përcaktojë fazën e përfundimit të një transaksioni ose kontrate ndërtimi duke përdorur metodën që mat në mënyrën më të besueshme punën e kryer. Metodat e mundshme përfshijnë:</u></p>

	<p><u>(a) metoda që bazohet në pjesën që zënë në koston totale të vlerësuara, shpenzimet e bëra për punën e kryer deri në një datë të caktuar. Shpenzimet e bëra për punën e kryer deri në atë datë nuk përfshijnë kostot që lidhen me aktivitetin e ardhshëm, të tilla si ato për materiale ose parapagimet.</u></p> <p><u>(b) metoda që bazohet në inspektimin e punës së kryer.</u></p> <p><u>(c) metoda që bazohet në përfundimin fizik të një pjesë të transaksionit të shërbimit ose punimeve të ndërtimit.</u></p> <p><u>Pagesat progresive dhe parapagimet e bëra nga blerësit, shpesh nuk pasqyrojnë punën e kryer.</u></p>
30	<p><u>Një njësi ekonomike duhet të njohë shpenzimet që kanë të bëjnë me aktivitete të ardhshme në lidhje me shërbimin ose kontratën e ndërtimit, të tilla si shpenzime për materiale ose parapagimet, si një aktiv, nëse është e mundur që këto shpenzime të rikuperohen.</u></p> <p><u>Kur një shitës shërbimesh i dërgon klientit fatura për shumën më të mëdha ose më të vogla se të ardhurat e llogaritura sipas metodës së fazës së përfunduar, atëherë diferenca do të njihet ose si detyrim, ose si e kërkesë e arkëtueshme.</u></p>
31	<p><u>Një njësi ekonomike duhet të njohë si një shpenzim të menjëhershëm çdo kosto që nuk është e mundur të rikuperohet.</u></p>
32	<p><u>Kur rezultati i një kontrate shërbimi apo ndërtimi nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme:</u></p> <p><u>(a) një njësi ekonomike duhet të njohë të ardhurat vetëm në masën e kostove të kryera të kontratës, të cilat është e mundur të rikuperohen, dhe</u></p> <p><u>(b) njësi ekonomike duhet të njohë kostot e kontratës si një shpenzim në periudhën në të cilën ato janë kryer.</u></p>
33	<p><u>Në rastet kur kostot totale tejkalojnë të ardhurat totale të një kontrate shërbimi apo ndërtimi, humbja e pritshme do të njihet menjëherë si një shpenzim, kundrejt një provizionit korrespondues për një kontratë në kushte rënduese (shih SKK 6).</u></p>
34	<p><u>Nëse nuk është më i mundur arkëtimi i një shume, të njohur tashmë si e ardhur, njësi ekonomike do ta njohë shumën e paarkëtueshme si një shpenzim në vend që të bëjë një rregullim të shumës së të ardhurave të kontratës.</u></p> <p><u>Metoda e fazës së përfunduar do të zbatohet në mënyrë kumulative në çdo periudhë kontabël, duke marrë në konsideratë vlerësimet e të ardhurave dhe të shpenzimeve të kontratave të bëra në bilancin e çeljes. Ndryshimet në vlerësimet e periudhës kontabël dhe ato të bilancit të çeljes njihen si të ardhura ose shpenzime të periudhës kontabël, dhe jo në mënyrë retrospektive.</u></p>
	<p><u>Të ardhurat nga kontratat e shërbimeve dhe të ndërtimit</u></p>
35	<p>Të ardhurat nga kontratat e <u>shërbimeve dhe të ndërtimit</u> përbëhen nga:</p> <p>(a) shumën <u>fillestare</u> e pagesës <u>fillestare</u> të vendosur në kontratë;</p> <p>(b) ndryshimet në volumin e punës që ndodhin gjatë realizimit të kontratës, kërkesat për zhdëmtim, si dhe pagesat stimuluese-shtesë, vetëm atëherë kur:</p> <p>(i) ato mund të sjellin të <u>ardhurahyra për njësinë ekonomike</u>;</p> <p>(ii) mund të maten me besueshmëri.</p>
36	<p>Të ardhurat nga kontratat e <u>shërbimeve dhe të ndërtimit</u> shpesh ndikohen nga ngjarje që ndodhin në të ardhmen, prandaj të ardhurat e <u>për llogaritura-vlerësuara</u> të kontratës duhet të rishikohen në çdo datë <u>raportimi të bilancit</u>. Ndryshime në të ardhurat e kontratës mund të shkaktohen, për shembull nga ndryshimet në qëllimin/shtrirjen e kontratës, tarifat shtesë ose gjokat për përfundime të parakohshme apo të vonuara të projektit, si dhe arsye të tjera të ngjashme me këto.</p>
37	<p>Një ndryshim tipik që ndodh <u>gjatë kryerjes së shërbimeve në kontratat e shërbimeve dhe të ndërtimit</u> është ndryshimi i qëllimit/shtrirjes së punës nga ana e klientit që sjell pakësimin ose shtimin e të ardhurave <u>te të</u> kontratës. Një ndryshim i tillë përfshihet në të ardhurat e kontratës kur:</p> <p>(a) ka mundësi që klienti të miratojë ndryshimet në qëllimin/shtrirjen e kontratës;</p> <p>(b) ndryshimi në të ardhurat e kontratës, që vjen si rrjedhojë e ndryshimit në qëllimin/shtrirjen e punës, mund të matet me besueshmëri.</p>
38	<p>Një kërkesë për zhdëmtim është shumën që pala që ofron shërbimet, kërkon të marrë nga klienti ose një palë tjetër si rimbursim për kostot që nuk ishin parashikuar në</p>

	<p>çmimin e kontratës. Kjo kërkesë përfshihet në të ardhurat e kontratës kur:</p> <p>(a) negociatat me klientët, në lidhje me kërkesën, kanë arritur në atë pikë që pranimi është i mundshëm;</p> <p>(b) shumat që pritet të pranohet nga klienti mund të matet me besueshmëri.</p>
39	<p>Pagesa stimuluese është shumë që klienti është gati të paguajë, nëse disa standarde të specifikuar të performancës janë plotësuar ose tejkaluar nga ofruesi i shërbimeve. Për shembull, një kontratë mund të përmbajë një pagesë stimuluese për palën që kryen shërbimin, atëherë kur shërbimi apo ndërtimi përfundon kryhet para kohe. Pagesat stimuluese përfshihen në të ardhurat e kontratës kur:</p> <p>(a) shërbimet apo punimet e ndërtimit ndodhet ndodhen në një fazë të tillë të avancuar sa është e mundshme që standardet e specifikuar të performancës të tejkalohen;</p> <p>(b) shumat e pagesës stimuluese mund të matet me besueshmëri.</p>
	<p><u>Shpenzimet nga Kostot e kontratave të shërbimeve dhe të ndërtimit</u></p>
40	<p>Kostot e kontratave të shërbimeve dhe të ndërtimit -përfshijnë:</p> <p>(a) shpenzimet-kostot që lidhen direkt drejt përdrejt me kontratën specifike;</p> <p>(b) shpenzimet-kostot e përgjithshme që lidhen me kontratën specifike;</p> <p>(c) shpenzime-kosto të tjera që i ngarkohen në mënyrë specifike klientit.</p>
41	<p>Për shembull, në rastin e një kontrate ndërtimi, shpenzimet që lidhen direkt me kryerjen e shërbimeve përfshijnë:</p> <p>(a) pagat e punëtorëve të ndërtimit;</p> <p>(b) shpenzimet e materialeve të ndërtimit;</p> <p>(c) amortizimin e aktiveve afatgjata materiale të përdorura në ndërtim;</p> <p>(d) shpenzimet e transportit të pajisjeve dhe materialeve;</p> <p>(e) shpenzimet e pajisjeve të marra me qira për ndërtim;</p> <p>(f) shpenzimet e projektimit dhe të asistencës teknike;</p> <p>(k) kostot e parashikuara të garancisë;</p> <p>(g) shpenzimet e projektimit dhe të asistencës teknike, që lidhet direkt me kontratën e ndërtimit;</p> <p>(h) kërkesat për zhdëmtim nga palët e treta.</p> <p>Kostot e kontratave të ndërtimit mund të mos zvogëlohen nga të ardhurat që vijnë si rezultat, për shembull i shitjes së materialeve të tepërta ose i shitjes së pajisjeve dhe makinerive pas kryerjes së shërbimit.</p>
	<p>Shembuj të shpenzimeve të përgjithshme, që kanë të bëjnë me kontratat e shërbimeve, janë:</p> <p>sigurimet;</p> <p>shpenzimet e projektimit dhe të asistencës teknike, që nuk lidhen direkt me kryerjen e një shërbimi specifik.</p> <p>Shpenzime të tilla shpërndahen midis shërbimeve në mënyrë sistematike dhe racionale, si dhe në përputhje me qëllimin normal të aktivitetit.</p>
42	<p>Shpenzimet që nuk lidhen në mënyrë direkt me kryerjen e një shërbimi dhe që nuk janë shpenzime të një natyre të përgjithshme, përjashtohen nga kostot e shërbimeve.</p> <p>Shembuj të shpenzimeve të tilla janë:</p> <p>shpenzimet e administrimit të përgjithshëm, rimbursimi i të cilave nuk specifikohet në kontratë;</p> <p>shpenzimet e marketingut dhe të shitjes;</p> <p>shpenzimet e kërkimeve dhe zhvillimit, rimbursimi i të cilave nuk specifikohet në kontratë;</p> <p>amortizimi i aktiveve afatgjata materiale që nuk përdoren për kryerjen e shërbimeve.</p>
43	<p>Shpenzimet-Kostot e përgjithshme, që lidhen me kontratën e shërbimeve apo të ndërtimit, përfshihen në kostot e kontratës nga data e lidhjes së kontratës deri në</p>

	<p>përfundimin e saj. Shpenzimet-Kostot që lidhen direkt me kontratën dhe që janë bërë gjatë procesit për të fituar dhe lidhur këtë kontratë përfshihen gjithashtu në koston e kontratës, nëse ato mund të identifikohen dhe maten më vete me besueshmëri. Kur shpenzimet-kostot që lidhen direkt me kontratën dhe që janë bërë gjatë procesit për të fituar dhe lidhur këtë kontratë njihen si shpenzim në një periudhë kontabël, ndërkohë që kontrata lidhet në periudhën kontabël pasardhëse, atëherë këto shpenzime-kosto nuk përfshihen në kostot e kontratës në mënyrë prospektive.</p>
	<p>Një ofrues shërbimesh mund të kryejë shpenzime në përputhje me kushtet e kontratës në një periudhë kontabël, të cilat faktikisht njihen si shpenzime në periudhën kontabël pasardhëse (për shembull materiale që janë blerë, por nuk janë përdorur; paradhëniet për nënkontraktorët etj.). Shpenzime të tilla kapitalizohen si një aktiv në zërin përkatës në datën e bilancit të periudhës kontabël dhe nuk përfshihen në shpenzime.</p>
	<p>INTERESAT, TË ARDHURAT NGA PËRDORIMI I PRONËS DHE DIVIDENDËT</p>
44	<p>Një njësi ekonomike njih të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi prej të tjerëve nga palë të treta i aktiveve të saj që sjellin interes, përfitim pagesash për përdorime të pronës (rojëliti) dhe dividendë mbi bazat e përcaktuara në paragrafin 45 kur:</p> <p>(a) është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në njësinë ekonomike, dhe</p> <p>(b) shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme.</p> <p>Të ardhurat nga dhënia për përdorim e aktiveve të njësisë ekonomike me interes, shfrytëzimi i pronësisë (rojëliti) dhe dividendët do të njihen kur:</p> <p>(a) arkëtimi i të ardhurave është i mundur;</p> <p>(b) shuma e të ardhurave mund të përcaktohet me besueshmëri.</p>
45	<p>Të ardhurat njihen si më poshtë:</p> <p>(a) të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e metodës lineare ose të metodës së bazuar në normën e brendshme të interesit efektiv (kontabilizimi, në bazë të normës së brendshme të interesit efektiv, përshkruhet gjithashtu në SKK 3, <i>Instrumentet Financiare</i>);</p> <p>(b) të ardhurat nga shfrytëzimi i pronësisë (rojëliti) njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, në përputhje me kushtet e kontratës;</p> <p>(c) të ardhurat nga dividendët njihen kur aksionari ka të drejtë ligjore për ta arkëtuar atë (dividendin).</p>
	<p>PARAQITJA NË PASQYRËN E POZICIONIT FINANCIAR DHE NË PASQYRËN E TË ARDHURAVE E SHPENZIMEVE</p>
46	<p>Tepricat që rezultojnë nga kontratat e papërfunduara të shërbimeve dhe të ndërtimit duhet të paraqiten si më poshtë:</p> <p>(a) shuma totale e tepricave pozitive të punës në proces duhet të përfshihet në aktivet afatshkurtra në një zë më vete në bilanepasqyrën e pozicionit financiar. Këto teprica përfaqësojnë shumën e papaguara nga klientët;</p> <p>(b) shuma totale e tepricave negative të punës në proces duhet të përfshihen në pasivet afatshkurtra brenda grupit të pasiveve të pagueshme nga aktiviteti dhe pasive të tjera të pagueshme. Këto teprica përfaqësojnë të ardhura të shtyra dhe duhet të përshkruhen si shuma që njësi ekonomike u detyrohet klientëve;</p> <p>(c) shumën e faturuara klientëve, pagesat e të cilave nuk janë marrë në datën e bilancitraportimit Këto teprica duhet të paraqiten si kërkesa të arkëtueshme nga aktiviteti.</p>
47	<p>Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të përfshin të ardhurat totale të periudhës kontabël.</p>
	<p>SHËNIMET SHPJEGUESE</p>
48	<p>Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, në lidhje me të ardhurat, duhet të paraqitet informacioni i mëposhtëm:</p> <p>(a) politikat kontabël, të përdorura për njohjen e të ardhurave, si dhe metodat e përdorura për përcaktimin e volumit të shërbimeve të kryera (për shembull, njohja e të</p>

	ardhurave nga kontratat e shërbimeve afatgjata, tarifat e konjeksionit, etj.) (b) shuma e çdo kategorie të rëndësishme të të ardhurave të njohura gjatë periudhës kontabël, duke reguar vecmaspërfshirë të ardhurat që vijnë nga: i) shitja e mallrave dhe e produkteve ; ii) kryerja e shërbimeve; iii) interesi; iv) të ardhurat nga shfrytëzimi i pronësisë (rojëliti); v) dividendët; vi) kontratat e ndërtimit.																										
49	Një njësi ekonomike, në lidhje me kontratat e ndërtimit, në shënimet shpjeguese duhet të japë informacionet në vijim: (a) shumën e të ardhurave të kontratës të njohura si të ardhura gjatë periudhës. (b) metodat e përdorura për të përcaktuar të ardhurat e kontratës të njohura gjatë periudhës. (c) metodat e përdorura për të përcaktuar fazën e përfundimit të kontratave në proces. (d) shumën bruto të kërkesave për t'u arkëtuar nga klientët për punë të kontraktuar si një aktiv. (e) shumën bruto të detyrimeve ndaj klientëve për punë të kontraktuar si një detyrim në pasiv;																										
	DATA E HYRJES NË ZBATIM																										
50	Ky Standard do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël, që fillojnë më ose pas datës 1 janar 20082014 . Ky Standard duhet të zbatohet në mënyrë prospektive-retrospektive . nga data 1 janar 2008, d.m.th. pa ndryshuar pasqyrat financiare krahasuese të vitit 2007, të cilat janë përgatitur sipas kërkesave ekzistuese të kontabilitetit. Ky qëndrim do të zbatohet për të gjitha SKK të. Nuk lejohet që disa SKK të zbatohen në mënyrë prospektive dhe disa të tjera në mënyrë retrospektive.																										
	KRAHASIMI ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR PER NJËSITE E VOGLA DHE TË MESME(SNK/SNRF PËR NVM)																										
51	Tabela më poshtë tregon se si korrespondojnë paragrafët e këtij Standardi me SNK të/SNRF të përkatëse -SNRF për NVM-të. Paragrafët janë trajtuar si korresponduese, nëse ato trajtojnë në përgjithësi të njëjtën çështje, pavarësisht nga fakti që përshkrimet në standardet e referuara mund të kenë ndryshim.																										
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Paragrafët sipas SKK 8</th> <th>Paragrafët sipas SNRF për NVM-të botuar në Korrik 2009</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Paragrafi 1</td> <td>Asnjë</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 2</td> <td>Asnjë</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 3</td> <td>Asnjë</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 4</td> <td>Sek 23.1</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 5</td> <td>Sek 23.2</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 6</td> <td>Asnjë</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 7</td> <td>Sek 23.4</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 8</td> <td>Asnjë</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 9</td> <td>Sek 23.3</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 10</td> <td>Asnjë</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 11</td> <td>Sek 23.5</td> </tr> <tr> <td>Paragrafi 12</td> <td>Sek 23.6</td> </tr> </tbody> </table>	Paragrafët sipas SKK 8	Paragrafët sipas SNRF për NVM-të botuar në Korrik 2009	Paragrafi 1	Asnjë	Paragrafi 2	Asnjë	Paragrafi 3	Asnjë	Paragrafi 4	Sek 23.1	Paragrafi 5	Sek 23.2	Paragrafi 6	Asnjë	Paragrafi 7	Sek 23.4	Paragrafi 8	Asnjë	Paragrafi 9	Sek 23.3	Paragrafi 10	Asnjë	Paragrafi 11	Sek 23.5	Paragrafi 12	Sek 23.6
Paragrafët sipas SKK 8	Paragrafët sipas SNRF për NVM-të botuar në Korrik 2009																										
Paragrafi 1	Asnjë																										
Paragrafi 2	Asnjë																										
Paragrafi 3	Asnjë																										
Paragrafi 4	Sek 23.1																										
Paragrafi 5	Sek 23.2																										
Paragrafi 6	Asnjë																										
Paragrafi 7	Sek 23.4																										
Paragrafi 8	Asnjë																										
Paragrafi 9	Sek 23.3																										
Paragrafi 10	Asnjë																										
Paragrafi 11	Sek 23.5																										
Paragrafi 12	Sek 23.6																										

	Paragrafi 13	Sek 23.7
	Paragrafi 14	Sek 23.8
	Paragrafi 15	Sek 23.9
	Paragrafi 16	Sek 23.10
	Paragrafi 17	Sek 23.11
	Paragrafi 18	Sek 23.12
	Paragrafi 19	Sek 23.13
	Paragrafi 20	Sek 23.14
	Paragrafi 21	Sek 23.14
	Paragrafi 22	Asnjë
	Paragrafi 23	Sek 23.15
	Paragrafi 24	Sek 23.17
	Paragrafi 25	Sek 23.18
	Paragrafi 26	Sek 23.19
	Paragrafi 27	Sek 23.20
	Paragrafi 28	Sek 23.21
	Paragrafi 29	Sek 23.22
	Paragrafi 30	Sek 23.23
	Paragrafi 31	Sek 23.24
	Paragrafi 32	Sek 23.25, Sek 23.16
	Paragrafi 33	Sek 23.26
	Paragrafi 34	Sek 23.27
	Paragrafi 35	Asnjë
	Paragrafi 36	Asnjë
	Paragrafi 37	Asnjë
	Paragrafi 38	Asnjë
	Paragrafi 39	Asnjë
	Paragrafi 40	Asnjë
	Paragrafi 41	Asnjë
	Paragrafi 42	Asnjë
	Paragrafi 43	Asnjë
	Paragrafi 44	Sek 23.28
	Paragrafi 45	Sek 23.29
	Paragrafi 46	Asnjë
	Paragrafi 47	Asnjë
	Paragrafi 48	Sek 23.30
	Paragrafi 49	Sek 23.31, Sek 23.32
	Paragrafi 50	Asnjë

	Paragrafi 51	Asnjë
	BAZA E KONKLUZIONEVE	
	HYRJE	
BK1	SKK 8, që u publikua në vitin 2006 para se të bëhej prezantimi i SNRF për NVM-të nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, bazohej fillimisht në SNK 18 dhe SNK11. SNRF për NVM-të u publikuan në vitin 2009. Ato përfaqësojnë një formë të thjeshtuar të SNRF-ve të përshtatshme për njësitë ekonomike pa përgjegjësi publike.	
BK2	Në 24 nëntor 2012, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ('KKK') mori vendimin për të rishikuar SKK-të ekzistuese me qëllimin për t'i përshtatur kërkesat e kontabilitetit me SNRF për NVM-të. Ky vendim u mor me qëllim që kërkesat e kontabilitetit të detyrueshme për njësitë ekonomike shqiptare, të cilave nuk u kërkohet të zbatojnë SNRF-të në përgatitjen e pasqyrave financiare, sipas ligjit 9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, të ishin në përputhje me kriteret ndërkombëtare.	
BK3	KKK-ja shqyrtoi mundësinë për zëvendësimin e SKK-ve ekzistuese me SNRF për NVM-të, por vendosi të mos e bëjë një gjë të tillë duke qenë se SNRF për NVM-të nuk janë plotësisht në përputhje me direktivat e BE-së për Legjislacionin e Shoqërive. KKK-ja do ta rishqyrtojë këtë alternativë pasi Direktiva e BE-së e përditësuar dhe SNRF për NVM-të të përditësuara të jenë publikuar.	
BK4	Ndryshimet e bëra në versionin e përmirësuar të SKK 8 janë të pjesshme krahasuar me Seksionin 23 të SNRF për NVM-të. KKK-ja e ka shfrytëzuar rishikimin e SKK 8 për të hequr shembujt ilustrues të paraqitur në SKK 8 në versionin origjinal dhe e ka plotësuar këtë standard me një seksion që përmban Udhëzuesin për Zbatimin e tij, ku përfshihen shembuj më të plotë të zbatimit të standardit në dobi të hartuesve të pasqyrave financiare.	
	OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES (Paragrafët 1 deri 3)	
BK5	Paragrafi 2 i SKK 8 në versionin origjinal është ndryshuar për t'iu referuar Seksionit 23 të SNRF për NVM-të. Tabela korresponduese midis SKK-ve dhe SNRF-ve është ndryshuar për të paraqitur krahasimin me SNRF për NVM-të.	
BK6	Paragrafi 4 në versionin origjinal është hequr pasi aspektet e dhëna në të, janë dhënë tashmë në paragrafin 1 të Standardit të përmirësuar. Paragrafi 4 është hequr për të shmangur përsëritjet e panevojshme.	
BK7	Paragrafi 5 në versionin origjinal i cili përcakton kriteret e njohjes së të ardhurave, është hequr nga kapitulli "Objektivi dhe bazat e përgatitjes" dhe është paraqitur tek kapitulli "Njohja e të ardhurave" (paragrafi i ri 8).	
	FUSHA E ZBATIMIT (Paragrafët 4 deri 5)	
BK8	Paragrafi 6 në versionin origjinal (paragrafi i ri 4) është ndryshuar për të reflektuar më mirë përmbajtjen e standardit duke përfshirë në mënyrë specifike kontratat e ndërtimit. Gjithashtu, është shtuar fjala "produkte" tek referenca që i bëhet "mallit", përkufizimi i të cilës jepet në kapitullin "Përkufizimet kryesore". Këto ndryshime janë bërë në përputhje me Seksionin 23 të SNRF për NVM-të.	
BK9	Paragrafët 7, 8, 9 dhe 10 në versionin origjinal janë hequr pasi ato japin detaje të cilat janë gjykuar nga KKK-ja se janë të tepërta në kontekstin e këtij Standardi.	
BK10	Paragrafi 10 në versionin origjinal në të cilat jepen përkufizimet e të ardhurave nga interesat, pagesat për përdorimin e pronës dhe dividendët është hequr pasi është gjykuar nga KKK-ja se është më e përshtatshme që ato të përfshihen në kapitullin "Përkufizimet kryesore".	
BK11	Paragrafi 11 në versionin origjinal është plotësuar/përmirësuar për t'iu përshtatur paragrafit përkatës të Seksionit 23 të SNRF për NVM-të. Gjithashtu, Seksioni 23 i SNRF për NVM-të nuk e përcakton shprehimisht që kontratat e sigurimit janë jashtë fushës së zbatimit të tij, pasi njësite ekonomike të përfshira në aktivitetet e sigurimit zbatojnë SNRF-të e plota. Megjithatë, KKK-ja ka gjykuar që Standardi i përmirësuar ta përcaktojë në mënyrë të shprehur përjashtimin nga fusha e zbatimit të tij kontratat e sigurimit, për të qartësuar përdorimin e këtij standardi nga hartuesit dhe përdoruesit e pasqyrave financiare.	
	PERKUFIZIMET KRYESORE (Paragrafët 6 dhe 7)	
BK12	Paragrafi i përkufizimeve (paragrafi 12 në versionin origjinal, dhe paragrafi i ri 6) është mbajtur sepse mendohet se është i nevojshëm për kuptueshmërinë dhe zbatueshmërinë e Standardit. Paragrafi 12 në versionin origjinal është plotësuar me përkufizimet e të ardhurave nga interesat, nga përdorimi i pronës dhe nga dividendët, si dhe me dy përkufizime të reja, përkufizimin e "mallit" dhe të "produktit". KKK-ja gjykon se këto ndryshime e bëjnë më të lexueshëm Standardin pasi të gjitha përkufizimet e nevojshme janë të përmbledhur brenda të njëjtit kapitull.	

BK13	Paragrafi 13 në versionin origjinal (paragrafi i ri 7) është riformuluar për t'iu përshtatur përcaktimeve të dhëna në Seksionin 23 të SNRF për NVM-të. Shembulli i dhënë pas paragrafit 13 të versionit origjinal është hequr në Standardin e përmirësuar pasi ai është përfshirë në Udhëzuesin për Zbatimin e SKK 8.
	NJOHJA E TE ARDHURAVE (Paragrafi 8)
BK14	Paragrafi 5 në versionin origjinal i cili përcakton kriteret e njohjes së të ardhurave, është hequr nga kapitulli “Objektivi dhe bazat e përgatitjes” dhe është paraqitur tek kapitulli “Njohja e të ardhurave”, paragrafi i ri 8.
	MATJA E TE ARDHURAVE (Paragrafët 9 dhe 13)
BK15	Paragrafi 14 dhe 15 në versionin origjinal, të cilet përcaktojnë se të ardhurat njihen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme dhe se në vlerësimin e vlerës së drejtë merren në konsideratë edhe zbritjet e mundshme që i bëhen çmimit të transaksionit, janë bashkuar duke u përshtatur kështu me paragrafin përkatës të Seksionit 23 të SNRF për NVM-të. Gjithashtu, shembulli i dhënë pas paragrafit 15 të versionit origjinal është hequr në Standardin e përmirësuar pasi ai është përfshirë në Udhëzuesin për Zbatimin e SKK 8.
BK16	Në paragrafin 16 në versionin origjinal (paragrafi i ri 10) nuk është bërë asnjë ndryshim.
BK17	Është shtuar një paragraf i ri (paragrafi 11) në të cilin jepen përcaktime në lidhje me matjen e vlerës së drejtë të të ardhurave në rastin kur kemi shtyrje në kohë të arkëtimit. Ky plotësim bëhet në përputhje me Seksionin 23 të SNRF për NVM-të.
BK18	Paragrafët 17 dhe 18 në versionin origjinal (paragrafët e rinj 12 dhe 13) të cilët kanë të bëjnë me shkëmbimet e mallrave, produkteve dhe shërbimeve të njëjta ose të ndryshme janë përmirësuar për t'iu përshtatur Seksionit 23 të SNRF për NVM-të. Të dy paragrafët e rinj japin përcaktime më të qarta dhe më të plota në lidhje me se në ç'raste një njësi ekonomike duhet ose jo të njohë të ardhura, dhe në rastet e shkëmbimit të mallrave apo shërbimeve jo të ngjashme, si duhet të maten ato. Këto përcaktime KKK-ja i ka gjykuar të nevojshme për hartuesit dhe përdoruesit e pasqyrave financiare, dhe prandaj ka vendosur që t'i përfshijë në Standardin e përmirësuar. Gjithashtu, shembulli i dhënë pas paragrafit 18 të versionit origjinal është hequr në Standardin e përmirësuar pasi ai është përfshirë në Udhëzuesin për Zbatimin e SKK 8.
	IDENTIFIKIMI I TRANSAKSIONIT (Paragrafët 14 dhe 15)
BK19	Paragrafët 19 dhe 20 në versionin origjinal, duke reflektuar dhe formulimin e paragrafit përkatës të SNRF për NVM-të, u përfshinë në një paragraf të vetëm, paragrafi i ri 14. Gjithashtu, shembulli i dhënë pas paragrafit 19 të versionit origjinal është hequr në Standardin e përmirësuar pasi ai është përfshirë në Udhëzuesin për Zbatimin e SKK 8.
BK20	Meqenëse bonuset e besnikërisë dhënë blerësave në shitjet me pakicë janë bërë një transaksion shumë i përhapur biznesi, u gjet me vend nga KKK-ja futja e një paragrafi të ri që mbulon trajtimin kontabël të të ardhurave që gjenerohen nga bonuset e besnikërisë, paragrafi i ri 15. Ky ndryshim bëhet në përputhje me Seksionin 23 të SNRF për NVM-të.
	SHITJA E MALLRAVE DHE PRODUKTEVE (Paragrafët 16 deri 19)
BK21	Paragrafi 21 në versionin origjinal (paragrafi i ri 16) nuk është ndryshuar, me përjashtim të saktësimin të disa nga përkufizimet e përdorura.
BK22	Në paragrafin 22 në versionin origjinal (paragrafi i ri 17) është plotësuar me përcaktimin e dhënë në paragrafin përkatës të Seksionit 23 të SNRF për NVM-të se për të vlerësuar nëse një njësi ekonomike ka transferuar rreziqet dhe përfitimet kryesore lidhur me pronësinë tek blerësi, kërkohet një analizë e rrethanave të transaksionit. KKK-ja ka gjykuar se ky ndryshim është i nevojshëm pasi i drejton hartuesit e pasqyrave financiare tek rrethanat e transaksionit kur ata përcaktojnë nëse rreziqet dhe përfitimet lidhur me pronësinë kalojnë ose jo tek blerësi. Gjithashtu, shembulli i dhënë pas paragrafit 22 të versionit origjinal është hequr në Standardin e përmirësuar pasi ai është përfshirë në Udhëzuesin për Zbatimin e SKK 8.
BK23	Në paragrafin 23 në versionin origjinal (paragrafi i ri 18), shtohet pika (a), për të përputhur kërkesat e paragrafit të këtij standardi me paragrafin përkatës të SNRF për NVM-të. Ndryshimi ka të bëjë me detyrimin që mbart shitësi për rezultate të pakënaqshme të cilat nuk mbulohen nga garanci normale, si një nga situatat që tregojnë se rreziqet dhe përfitimet kryesore lidhur me pronësinë nuk kanë kaluar tek blerësi. Paragrafi 24 në versionin origjinal (paragrafi i ri 19) nuk ka ndryshuar, me përjashtim të saktësimeve të disa përkufizimeve. Gjithashtu, shembujt e dhënë pas paragrafit 23 dhe 24 të versionit origjinal janë hequr në Standardin e përmirësuar pasi ata janë përfshirë në Udhëzuesin për Zbatimin e SKK 8.
BK24	Paragrafi 25 në versionin origjinal është hequr pasi kërkesat e këtij paragrafi janë parashikuar në SKK 1.

	KRYERJA E SHËRBIMEVE (Paragrafët 20 deri 43)
	Kontratat e shërbimit (Paragrafët 20 deri 23)
BK25	Në Standardin e përmirësuar është shtuar një paragraf i ri (paragrafi 20) në të cilin përcaktohet se të ardhurat nga shërbimet, kur ato maten me besueshmëri, njihen mbi bazën e metodës së përfundimit. Plotësimi i Standardit me këtë paragraf të ri, bëhet në përputhje me Seksionin 23 të SNRF për NVM-të.
BK26	Paragrafi 26 në versionin origjinal (paragrafi i ri 21) nuk është ndryshuar, me përjashtim të saktësisimit të disa nga përkufizimet e përdorura.
BK27	Paragrafi 27 në versionin origjinal është hequr, pasi përcaktimet e dhëna në të lidhje me kushtet që dëshmojnë se rezultati i një transaksioni mund të matet me besueshmëri nuk kërkohen nga Seksioni 23 i SNRF për NVM-të. SNRF për NVM-të nuk e detyrojnë njësinë ekonomike që të plotësojë kushte, por e lë në gjykimin e kësaj të fundit që të vlerësojë nëse shumica e të ardhurave mund të matet me besueshmëri ose jo. KKK-ja e ka gjykuar me vend që në lidhje me këtë aspekt të bëhet ndryshimi në përputhje me Seksionin 23 të SNRF për NVM-të.
BK28	Paragrafi 28 në versionin origjinal është hequr pasi përcaktimet e dhëna në të janë përfshirë në kapitullin “Metoda e fazës së përfundimit”.
BK29	Paragrafi 29 në versionin origjinal (paragrafi i ri 22) është thjeshtuar për të lënë vetëm referencën e bërë tek kapitulli “Metoda e fazës së përfundimit”.
BK30	Është shtuar një paragraf i ri (paragrafi 23) i cili përcakton kritere për mënyrën e njohjes së të ardhurave në një transaksion i cili përbëhet nga një numër veprimesh. Plotësimi i Standardit me këtë paragraf të ri, bëhet në përputhje me Seksionin 23 të SNRF për NVM-të.
BK31	Paragrafët 30, 31, 32, 33, 34 dhe 35 në versionin origjinal janë hequr pasi përcaktimet e dhëna në to jepen në kapitullin “Metoda e fazës së përfundimit”.
BK32	KKK-ja ka gjykuar që paragrafin 16 të Seksionit 23 të SNRF për NVM-të ta përfshijë në kapitullin “Metoda e fazës së përfundimit”, meqenëse ky kapitull përcakton kriteret e zbatimit të metodës së fazës së përfundimit si për kontratat e ndërtimit ashtu dhe të shërbimit. Ky ndryshim bëhet për të siguruar një rrjedhë llogjike të Standardit të përmirësuar nga hartuesit dhe përdoruesit e pasqyrave financiare.
	Kontratat e ndërtimit (Paragrafët 24 deri 27)
BK33	KKK-ja ka gjykuar me vend që të ristrukturojë SKK 8 duke futur një kapitull të posaçëm për kontratat e ndërtimit për dy arsye: së pari sektori i ndërtimit zë një peshë të konsiderueshme të transaksioneve të biznesit dhe prandaj kërkon një rregullim të dedikuar, dhe së dyti, vetë Seksioni 23 i SNRF për NVM-të ka një grup të veçantë paragrafësh për kontratat e ndërtimit. Ky ristrukturim e bën SKK 8 të përmirësuar të ketë një rrjedhë llogjike nga fillimi në fund.
BK34	Në Standardin e përmirësuar është shtuar një paragraf i ri (paragrafi 24) në të cilin përcaktohet se të ardhurat nga kontratat e ndërtimit, kur ato maten me besueshmëri, njihen mbi bazën e metodës së përfundimit. Plotësimi i Standardit me këtë paragraf të ri bëhet në analogji me ndryshimin e bërë tek kapitulli “Kontratat e shërbimit” dhe në përputhje me Seksionin 23 të SNRF për NVM-të.
BK35	Është shtuar një paragraf i ri (paragrafi 25) i cili përcakton zbatueshmërinë e kërkesave të Standardit të përmirësuar për çdo kontratë ndërtimi të marrë veçmas, të cilat në disa rrethana, zbatohen dhe mbi një grup kontratash të marra së bashku. Plotësimi i Standardit me këtë paragraf të ri, bëhet në përputhje me Seksionin 23 të SNRF për NVM-të.
BK36	Paragrafi ekzistues 36 dhe 37 (paragrafët e rinj 26 dhe 27) janë riformuluar në përputhje me paragrafët përkatës të Seksionit 23 të SNRF për NVM-të dhe duke i përshtatur ato për kontratat e ndërtimit, subjekt i këtij kapitulli. Gjithashtu, shembujt e dhënë pas paragrafit 36 dhe 37 të versionit origjinal janë hequr në Standardin e përmirësuar pasi ata janë përfshirë në Udhëzuesin për Zbatimin e SKK 8.
	Metoda e fazës së përfundimit (Paragrafët 28 deri 34)
BK37	KKK-ja ka gjykuar me vend që të ristrukturojë SKK 8 duke futur një kapitull të posaçëm për metodën e fazës së përfundimit, përcaktimet e të cilit zbatohen si për kontratat e shërbimit ashtu dhe për ato të ndërtimit. Edhe Seksioni 23 i SNRF për NVM-të ka një grup të veçantë paragrafësh për metodën e fazës së përfundimit. Ky ristrukturim e bën SKK 8 të përmirësuar të ketë një rrjedhë llogjike nga fillimi në fund.
BK38	Në Standardin e përmirësuar është shtuar një paragraf i ri (paragrafi 28) në të cilin përcaktohet qëllimi i përdorimit të metodës së fazës së përfundimit. Plotësimi i Standardit me këtë paragraf të ri bëhet në përputhje me Seksionin 23 të SNRF për NVM-të.
BK39	Paragrafi 38 në versionin origjinal është zëvendësuar me paragrafin e ri 29, në të cilin përshkruhen metodat e mundshme të fazës së përfundimit. Plotësimi i Standardit me këtë paragraf të ri bëhet në përputhje me Seksionin 23 të SNRF për NVM-të. KKK-ja ka gjykuar se mënyra se si përshkruhen këto metoda nga Seksioni 23 i SNRF

	për NVM-të është më i qartë për hartuesit dhe përdoruesit e pasqyrave financiare.
BK40	Paragrafi 39 në versionin origjinal është hequr pasi përcaktimet e dhëna në këtë paragraf nuk jepen nga Seksioni 23 i SNRF për NVM-të. KKK-ja e ka gjykuar të panevojshme mbajtjen e këtij paragrafi në Standardin e përmirësuar pasi këto përcaktime nuk kanë të bëjnë me metodën e fazës së përfundimit. Paragrafi 39 është zëvendësuar me paragrafin e ri 30, në të cilin përcaktohet se nëse njësia ekonomike kryen shpenzime që kanë të bëjnë me aktivitete të ardhshme të kontratës së ndërtimit, atëherë këto shpenzime njihen si aktiv, nëse është e mundur që ato të rikuperohen. Plotësimi i Standardit me këtë paragraf të ri bëhet në përputhje me Seksionin 23 të SNRF për NVM-të.
BK41	Në Standardin e përmirësuar janë shtuar paragrafet e rinj 31, 32, 33 dhe 34, të cilat japin trajtimet kontabël të rrethanave të ndryshme gjatë zbatimit të metodës së fazës së përfundimit. Plotësimi i Standardit me këto paragrafe të rinj bëhet në përputhje me Seksionin 23 të SNRF për NVM-të, të cilat KKK-ja i ka gjykuar të nevojshme për të rritur kuptueshmërinë e kësaj metode dhe lehtësinë në zbatimin e saj nga hartuesit e pasqyrave financiare.
BK42	Paragrafi 40 në versionin ekzistues i cili përcakton se metoda e fazës së përfundimit zbatohet në mënyrë kumulative në çdo datë raportimi është hequr pasi KKK-ja ka gjykuar se ky aspekt sqarohet nëpërmjet shembujve ilustrues. Ndryshimi bëhet në përputhje me Seksionin 23 të SNRF për NVM-të. Gjithashtu, shembulli i dhënë pas paragrafit 40 të versionit origjinal është hequr në Standardin e përmirësuar pasi ai është përfshirë në Udhëzuesin për Zbatimin e SKK 8.
	Të ardhurat nga kontratat e shërbimeve dhe të ndërtimit (Paragrafët 35 deri 39)
BK43	Paragrafët 41-45 në versionin origjinal, të cilat trajtojnë aspekte të ndryshme në lidhje me të ardhurat nga shërbimet, janë përfshirë dhe në Standardin e përmirësuar (paragrafët e rinj korrespondues 35 – 39) pasi KKK-ja ka gjykuar se kjo i shërben kuptueshmërisë së Standardit nga ana e hartuesve dhe përdoruesve të pasqyrave financiare, edhe pse Seksioni 23 i SNRF për NVM-të nuk i përcakton ato. Këta paragrafë janë mbajtur të pandryshuar në Standardin e përmirësuar, me përjashtim të saktësisimit të disa nga përkufizimet e përdorura, si dhe referencës së bërë jo vetëm tek kontratat e shërbimit por dhe tek ato të ndërtimit.
	Kostot e kontratave të shërbimeve dhe të ndërtimit (Paragrafët 40 deri 43)
BK44	Paragrafët 46-51 në versionin origjinal, të cilat trajtojnë aspekte të ndryshme në lidhje me kostot e kontratave të shërbimit, janë përfshirë dhe në Standardin e përmirësuar (paragrafët e rinj korrespondues 40 – 43) pasi KKK-ja ka gjykuar se kjo i shërben kuptueshmërisë së Standardit nga ana e hartuesve dhe përdoruesve të pasqyrave financiare, edhe pse Seksioni 23 i SNRF për NVM-të nuk i përcakton ato. Këta paragrafë janë mbajtur të pandryshuar në Standardin e përmirësuar, me përjashtim të saktësisimit të disa nga përkufizimet e përdorura, si dhe referencës së bërë jo vetëm tek kontratat e shërbimit por dhe tek ato të ndërtimit. Gjithashtu, shembujt e dhënë në paragrafin 47, 48, 49 dhe pas paragrafit 51 të versionit origjinal janë hequr në Standardin e përmirësuar pasi at janë përfshirë në Udhëzuesin për Zbatimin e SKK 8.
	INTERESAT, TË ARDHURAT NGA PËRDORIMI I PRONËS DHE DIVIDENDET (Paragrafët 44 deri 45)
BK45	Asnjë ndryshim nuk është bërë në këtë kapitull të Standardit, me përjashtim të disa reformulimeve për t'iu përshtatur Seksionit 23 të SNRF për NVM-të. Shembulli i dhënë pas paragrafit 23 të versionit origjinal është hequr në Standardin e përmirësuar pasi ai është përfshirë në Udhëzuesin për Zbatimin e SKK 8.
	PARAQITJA NË PASQYRËN E POZICIONIT FINANCIAR DHE NË PASQYRËN E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE (Paragrafët 46 dhe 47)
BK46	Asnjë ndryshim nuk është bërë në këtë kapitull të Standardit, me përjashtim të saktësisimit të disa nga përkufizimet e përdorura.
	SHËNIMET SHPJEGUESE (Paragrafët 48 dhe 49)
BK47	Paragrafi 56 i versionit origjinal (paragrafi i ri 48) është mbajtur i pandryshuar. Ndërkohë që është shtuar një paragraf i ri (paragrafi 49) i cili përcakton në mënyrë specifike shënimet shpjeguese që duhet të paraqesë një njësi ekonomike në pasqyrat e saj financiare sa i takon kontratave të ndërtimit. Ky paragraf i ri është i domosdoshëm pasi, së pari, Standardi i përmirësuar ka një kapitull më vete në lidhje me kontratat e ndërtimit, dhe si rrjedhim kjo kërkon të shoqërohet me kërkesat respektive në lidhje me shënimet shpjeguese, dhe së dyti, për t'iu përshtatur kërkesave të Seksionit 23 të SNRF për NVM-të.
	DATA E HYRJES NË ZBATIM (Paragrafi 50)
BK48	SKK 8 zbatohet në mënyrë retrospektive. Në përputhje me SKK 1 <i>Kuadri i Përgjithshëm për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare</i> , ndryshimi në politikat kontabël zbatohet në mënyrë retrospektive, që në fillim të periudhës më të hershme të paraqitur, përveç rasteve kur: (a) ndryshimi në politikën kontabël ka rezultuar nga një SKK i ri dhe për kalimin në metodën e re aplikime të ndryshme janë përshkruar në këtë SKK; ose (b) efekti i ndryshimit në politikat kontabël në periudhat e mëparshme nuk mund të përcaktohet në mënyrë të besueshme.

	UDHËZUES PËR ZBATIMIN E SKK 8
	Shembujt ilustrues të dhëna në këtë kapitull nuk janë pjesë integrale e SKK 8. Ato janë dhënë me qëllim kuptimin dhe zbatimin e drejtë të parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëposhëm të të ardhurave si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare, të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri.
	<i>Shembuj ilustrues për paragrafin 6 deri 7</i>
	<p><i>Shembulli 1 (marrëveshjet e agjencisë)</i> Njësia ekonomike A shpërndan produktet e njësisë ekonomike B në bazë të një marrëveshjeje të lidhur mes të dyja palëve. Termat dhe kushtet e kësaj kontrate janë të tilla mbi bazën e të cilave njësia ekonomike A:</p> <ol style="list-style-type: none"> fiton titullin ligjor mbi mallrat dhe ia shet atë shitësve të tjerë me pakicë; magazinon, ripaketon, transporton dhe faturon mallrat e shitura tek shitësit me pakicë; fiton një marzh të caktuar mbi produktet e shitura tek shitësit me pakicë, por nuk ka të drejta përsa i përket përcaktimit të çmimit të shitjes; ka të drejtë t'ia rikthejë mallrat njësisë ekonomike B pa paguar gjobë; dhe mban përgjegjësi për mallrat gjatë kohës që ato janë në magazinën e saj, ndërsa njësia B mban rrezikun e mallrave të vjetëruara/dala nga përdorimi. <p>Njësia ekonomike B mban përsipër detyrimet që lindin nga produkti. Pra, njësia ekonomike B është përgjegjëse për defektet e prodhimit dhe rreziqet e mos-arkëtimit mbeten po tek ajo.</p> <p><i>A duhet që njësia B të njohë të ardhurat me kalimin e mallrave tek njësia A?</i></p> <p>Jo. Njësia ekonomike A në thelb vepron si agjent për njësinë B. Njësia ekonomike B nuk ia kalon njësisë ekonomike A rreziqet dhe përfitimet që burojnë nga të drejtat e pronësisë mbi mallin. Njësia B luan një rol të vazhdueshëm në menaxhimin e mallrave. Njësia ekonomike A ka mundësinë t'ia kthejë mallrat dhe njësia ekonomike B mban rreziqet e lidhura me produktin dhe inventarin. Njësia ekonomike B vazhdon të kryejë menaxhimin e mallrave duke pasur të drejtën e vendosjes së çmimit të shitjes.</p> <p>Njësia ekonomike A duhet të njohë si të ardhura vetëm tarifën e agjencisë ose të ardhurat nga komisioni. Njësia ekonomike B duhet të vazhdojë të mbajë të regjistruar inventarin në pasqyrën e saj të pozicionit financiar. Njësia ekonomike B duhet të njohë të ardhurat nga shitja vetëm atëherë kur rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e mallit transferohen në masë të konsiderueshme tek njësia B, gjë e cila ndodh kur njësia A i'a shet mallrat një pale të tretë.</p> <p>Nëse një njësi ekonomike vepron si agjent apo si palë kryesore (pala që kërkon shërbimin e agjentit mbi bazën e një marrëveshjeje agjencie) varet gjithmonë nga faktet dhe rrethanat e marrëdhënies së lidhur. Minimalisht një palë kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> ka një marrëdhënie kontraktuale me konsumatorin e fundit që do të thotë se konsumatori i fundit beson se po kryen biznes me palën kryesore; është në gjendje të caktojë termat/kushtet e transaksioneve si p.sh. çmimin e shitjes dhe kushtet/afatet e pagesës; mban rreziqet që lidhen me inventarin; mban rreziqet e mos-arkëtimit të shitjeve; dhe ka nën kontroll fluksin e arkëtimit dhe të pagesave.
	<i>Shembuj ilustrues për paragrafët 8 deri 13</i>
	<p><i>Shembulli 2 (shitja e mallrave me montim, nëse shitësi e ka këtë detyrim)</i> Nëse montimi është një pjesë e rëndësishme e kostos së një transaksioni, të ardhurat njihen pasi është përfunduar montimi. Përrjashtimisht, të ardhurat njihen menjëherë pas dorëzimit të mallit nëse montimi nuk është i komplikuar dhe nuk kërkon shumë kohë (për shembull montimi i një makine larëse).</p>

Shembulli 3 (shitja me komision, kur një ndërmjetës shet mallra në emër të shitësit)

Shitësi njihet të ardhurat pasi ndërmjetësi i shet mallrat tek palët e treta.

Shembulli 4

Prodhimi i mallrave fillon pas marrjes së porosisë dhe blerësi ka bërë një parapagim për mallrat. Të ardhurat njihen pasi mallrat kanë përfunduar dhe i janë dorëzuar blerësit.

Shembulli 5

Parapagesat për dorëzimin e mallrave përgjatë një periudhe të caktuar (p.sh. parapagesat për botime periodike)

Të ardhurat nga shitjet shpërndahen përgjatë periudhës në të cilën mallrat i dërgohen klientit, në përpjestim me çmimin e shitjes së mallrave të dorëzuara. Nëse mallrat shpërndahen njëtrajtësisht gjatë të gjithë periudhës kohore (p.sh. shitja e botimeve periodike), të ardhurat njihen në mënyrë lineare.

Shembulli 6 (shitjet e pronave të patundshme)

Të ardhurat nga shitja e pronave të patundshme njihen kur të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë kalojnë nga shitësi te blerësi dhe blerësi nuk është i detyruar të kryejë ndonjë punë shtesë të rëndësishme mbi këtë pronë. Në përgjithësi, të ardhurat njihen në momentin kur titulli ligjor kalohet tek blerësi. Gjithashtu, në njohjen e të ardhurave duhet pasur parasysh fakti nëse parapagesa e bërë nga blerësi përbën një pjesë të konsiderueshme të çmimit të blerjes dhe si rrjedhim marrëveshja e shit-blerjes mund të konsiderohet si plotësisht e realizueshme. Nëse paradhënia përbën relativisht një pjesë të vogël të çmimit të shitjes së pronës së patundshme ose ka dyshime mbi mundësinë apo vullnetin e blerësit për të përfunduar transaksionin e blerjes, atëherë të ardhurat nga shitja njihen deri në shumën e paradhënies së marrë.

Shembulli 7 (skonto për pagesa të parakohshme)

Një njësi ekonomike shet ushqim të konservuar dhe ka 100 klientë. Dorëzimi i mallit bëhet ditën e fundit të çdo muaji. Afatet standarde të pagesës kërkojnë që pagesa të bëhet brenda 45 ditësh pas dorëzimit të mallit. Sipas politikës së ndjekur nga njësi ekonomike, klientëve që paguajnë brenda 15 ditëve pas dorëzimit të mallit u ofrohet një skonto prej 2% për pagesë të parakohshme. Përvoja ka treguar që 45% e klientëve zakonisht paguajnë brenda 15 ditëve dhe 55% e tyre paguajnë pas 15 ditësh. Njësi ekonomike dorëzon tek klientët e saj një parti ushqimesh më 31 janar 2013. Çmimi total i shitjeve të faturuara për të gjitha dërgesat arrin shumën 1,000 lekë.

Si do t'i trajtojë njësi ekonomike skontot për pagesë të parakohshme në datën e shitjes?

Njësi ekonomike duhet të njohë të ardhura me vlerën 991 lekë, e cila është diferenca midis vlerës reale të shumës së arkëtueshme të llogaritur si vlera bruto e shitjeve prej 1,000 lekë me shumën e përlllogaritur të skontos për pagesa të parakohshme prej 9 lekë (1,000 x 45% x 2%).

Gjithashtu, një provizion për 9 lekë duhet të regjistrohet me qëllim që të pasqyrohet në pasqyrat financiare detyrimi i njësisë ekonomike për t'i ofruar skonto klientëve të saj.

Regjistrimet kontabël do të jenë si më poshtë:

1.	Në momentin e shitjes:	
D	Kërkesa të arkëtueshme	1,000 lekë
K	Të ardhura nga shitja	991 lekë
K	Provisione për kërkesa të arkëtueshme të paguara para afatit	9 lekë

Rasti i parë:

A. Klientët arkëtojnë brenda 15 ditëve.

Teprica e kërkesave të arkëtueshme paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar me shumën neto, d.m.th. duke i zbritur provizionet për arkëtime të parakohshme.

2. Rimarrja e provizionit:

D	Provisione për kërkesa të arkëtueshme të paguara para afatit	9 lekë
K	Kërkesa të arkëtueshme	9 lekë

B. Klientët arkëtojnë pas 15 ditëve.

3. Rimarrja e provizionit:

D	Provisione për kërkesa të arkëtueshme të paguara para afatit	9 lekë
K	Të ardhura nga shitja	9 lekë

Shembulli 8

Një shoqëri ndërtimi ka gjendje tjegullash në Tiranë. Meqënëse kjo shoqëri po ndërton një godinë në Elbasan, në mënyrë që të kursejë shpenzimet e transportit, ajo ka bërë një marrëveshje me një shitës me shumicë të materialeve të ndërtimit në këtë qytet sipas së cilës shoqëria e ndërtimit do t'ia japë 35,000 tjegullat e saj shitësit me shumicë të materialeve të ndërtimit, duke marrë 35,000 tjegulla të tjera të së njëjtës cilësi dhe parametra, që ndodhen në magazinën qendrore të këtij shitësi. Meqënëse janë shkëmbyer mallra të njëjtë, nuk regjistrohen të ardhura dhe tjegullat e marra kontabilizohen me vlerën kontabël të tjegullave të dhëna.

Shembulli 9

Le të supozojmë që shoqëria e ndërtimit e përshkruar në shembullin e më sipër, shkëmben 35,000 tjegulla që ka në Tiranë me 100,000 pllaka të ndodhura në magazinën qendrore. Duke qënë se shkëmbehen mallra të ndryshëm, veprimi njihet si shitje tjegullash dhe blerje pllakash. Shoqëria duhet të regjistrojë të ardhurat duke përcaktuar fillimisht vlerën e drejtë të pllakave të marra. Vlera e drejtë mund të përcaktohet duke përdorur çmimet e tregut për të njëjtat pllaka ose pllaka të ngjashme në datën më të afërt me atë të transaksionit. Nëse vlera e drejtë e pllakave të marra nuk mund të përcaktohet me besueshmëri, atëherë të ardhurat do të njihen me vlerën e drejtë të tjegullave të dhëna. Diferenca mes vlerës së drejtë të pllakave të marra (ose vlera e drejtë e pllakave të shkëmbyera) dhe vlerës kontabël të tjegullave të dhëna njihet si fitim ose humbje nga shitja.

Shembulli 10 (tarifat për shërbimet e njëherëshme)

Shërbimet e njëherëshme që kryhen gjatë një periudhe të shkurtër kohe (p.sh. brenda një dite) njihen menjëherë si të ardhura pasi ato të kenë ndodhur. Shërbimet njëherëshme që kryhen gjatë një periudhe kohe të gjatë, njihen si të ardhura në bazë të metodës së fazës së përfundimit në datën e raportimit.

Shembulli 11 (kostot e mirëmbajtjes)

Kur mirëmbajtja ofrohet vetëm një herë (d.m.th. është një transaksion i vetëm që ofrohet vetëm një herë), atëherë të ardhurat njihen pasi shërbimi përfundon. Kur mirëmbajtja kryhet gjatë një periudhe kohe më të gjatë (d.m.th. përbëhet nga një ose disa transaksione të cilat ofrohen shumë herë), të ardhurat nga shërbimet e mirëmbajtjes njihen si të tilla mbi bazën e metodës lineare ose sipas ndonjë metodë tjetër përgjatë periudhës së mirëmbajtjes që përshkruhet në kontratë.

Shembulli 12 (tarifat e konjeksionit)

Tarifat e konjeksionit njihen si të ardhura në periudhën ushtrimore gjatë të cilës mendohet që klientët do të përdorin shërbimin e konjeksionit. Për shembull, një shoqëri ujësjellësi njehtarifat e konjeksionit me rrjetin e ujit në periudhën që shërbimi pritet të kryhet. Në rast se periudha e shitjes së shërbimit nuk është e përcaktuar në kontratë, atëherë tarifat e konjeksionit do të njihen si të ardhura përgjatë jetës së dobishme të investimeve të bëra për konjeksionin (p.sh tubacioni i ndërtuar).

Shembulli 13 (kuotat e anëtarësisë)

Kur një kuotë anëtarësie nuk siguron përfitime shtesë për anëtarët (për shembull, një mundësi për të blerë mallra me një çmim më të favorshëm), kjo kuotë njihet si e ardhur në kohën kur arkëtimi i saj është praktikisht i sigurt, duke marrë në konsideratë periudhën së cilës kjo kuotë i përket. Kur anëtarësia siguron përfitime shtesë për anëtarët, ajo njihet si e ardhur në periudhën ushtrimore kur parashikohet që ky përfitim të përdoret.

Shembulli 14 (shërbimet e medias dhe reklamës)

Për shitjen dhe ndërmjetësimin e shërbimeve të medias dhe reklamës, të ardhurat njihen në kohën e publikimit të reklamës në media. Për prodhimin e këtyre shërbimeve, të ardhurat njihen duke përdorur metodën e fazës së përfundimit.

Shembulli 15 (shfaqjet, koncertet dhe ngjarje të tjera)

Të ardhurat nga ngjarje të tilla kulturore njihen në kohën kur këto ndodhin. Nëse kryhet pagesë për një paketë me dy ose më shumë ngjarje, të ardhurat njihen në bazë të kostove që i përkasin çdo ngjarjeje.

Shembulli 16

Njësia ekonomike X është një agjenci udhëtimesh. Ajo i ofron klientëve një sërë shërbimesh me çmim të zbritur në këmbim të një kuotë vjetore anëtarësie që duhet të paguhet në avancë. Klientët kanë të drejtë të anullojnë marrëveshjen për anëtarësim në çdo kohë dhe të marrin një rimbursim të plotë të kësaj kuote nëse ata nuk kanë shfrytëzuar ndonjë nga këto shërbime që ofrohen. Në bazë të përvojës, njësia ekonomike X është në gjendje të parashikojë shkallën e anulimeve që mund të ndodhin në të ardhmen me një përqindje të vogël gabimi. Njësia ekonomike X ka mbi 5 milionë anëtarë të regjistruar.

Si duhet të njihen të ardhurat?

Të ardhurat nga kuotat duhet të njihen në një mënyrë të tillë që të pasqyrojë kohën, natyrën dhe vlerën e shërbimeve me çmim të zbritur që ofron njësia ekonomike X. Për shembull, kur shërbimet me çmim të zbritur duhet të shfrytëzohen gjatë periudhës ushtrimore, njësia ekonomike X duhet të njohë të ardhurat e saj sipas një norme të njëjtë gjatë gjithë periudhës ushtrimore. Vetëm në fund të periudhës ushtrimore, duke supozuar që klientët i kanë shfrytëzuar të gjitha shërbimet e ofruara me çmim të zbritur, njësia ekonomike X do të njohë totalin e kuotave të anëtarësisë.

Nga ana tjetër, në rast se kuota i ka dhënë klientit vetëm të drejtën e anëtarësisë, dhe të gjitha produktet dhe shërbimet paguhet më vete me çmim të plotë, atëherë njësia ekonomike duhet të njohë të ardhurat nga kuotat atëherë kur nuk ka pasiguri mbi arkëtimin e saj.

Njësia ekonomike X duhet të njohë një provizion për rimbursime të mundshme të kuotave në bazë të përvojës së shkuar. Regjistrimi përkatës duhet të jetë i tillë që të pakësojë të ardhurat.

Shembulli 17

Një prodhues shet njërin prej produkteve të tij për 500 lekë për njësi. Por, prodhuesi u ofron klientëve një skonto prej 20 për qind për porositë prej 100 njësi ose më shumë. Një klient blen 100 njësi në një porosi të vetme.

Si duhet t'i masë prodhuesi të ardhurat?

Prodhuesi duhet t'i masë të ardhurat nga shitja e mallrave me 40,000 lekë, d.m.th. $100 \text{ njësi} \times (500 \text{ lekë çmimi i listës minus } 100 \text{ lekë (d.m.th. } 20 \% \times 500 \text{ lekë) skonto në volum)}$.

Shembulli 18

Në ditën e parë të periudhës së raportimit vjetor, një njësi ekonomike e shiti inventarin me 2,000,000 lekë me kredi dyvjeçare pa interes kur çmimi aktual i shitjes së mallrave në mjete monetare ishte 1,652,893 lekë. Duke qenë se ka një diferencë prej 347,107 lekë ndërmjet çmimit në mjete monetare prej 1,652,893 lekë dhe shumës për t'u paguar sipas marrëveshjes për kredi dyvjeçare pa interes, marrëveshja është në fakt një transaksion financimi ashtu si edhe shitja e mallrave. Duke supozuar se norma e nënkuptuar e skontimit është e arsyeshme (për shembull duke pasur parasysh vlerën në kohë të parasë dhe kredinë e mbetur të konsumatorit), njësia ekonomike duhet t'i njohë të ardhurat nga shitja e mallrave në ditën e parë të periudhës së raportimit vjetor prej 1,652,893 lekë. Përveç kësaj, njësia ekonomike duhet t'i njohë të ardhurat e interesit prej respektivisht 165,289 lekë dhe 181,818 lekë në periudhën aktuale të raportimit vjetor dhe atë të ardhshme të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv, siç ilustruhet më poshtë.

Duke përdorur një tabelë ose një makinë llogaritëse financiare, norma e interesit të përcaktuar llogaritet me 10 përqind në vit (d.m.th. norma që skonton shumën nominale (2,000,000 lekë) të pagueshme në një kohë dyvjeçare me çmimin aktual të shitjes së mallrave në mjete monetare (1,652,893 lekë)).

Të ardhurat që rrjedhin nga shitja e mallrave përbëjnë çmimin aktual të shitjes në mjete monetare prej 1,652,893 lekë (d.m.th. vlera aktuale e pagesës së ardhshme).

Të ardhurat nga interesi për vitin e shitjes janë 165,289 lekë - llogaritja: $1,652,893 \text{ lekë vlera aktuale} \times 10 \text{ përqind (norma e interesit të përcaktuar)}$.

Të ardhurat nga interesi për vitin e ardhshëm janë 181,818 Lekë - Llogaritja: $(1,652,893 \text{ lekë vlera aktuale} + 165,289 \text{ lekë interesi i përllogaritur}) \times 10 \text{ përqind - norma e interesit të përcaktuar}$.

Shembulli 19

Më 1 janar 2011, për të përmbushur një porosi urgjente nga një klient, shitësi me pakicë i karburantit X mori 180,000 litra karburant motorik në Qytetin A nga një tjetër shitës karburanti me pakicë në këmbim të 180,000 litra të karburantit të tij motorik në qytetin B. Karburanti motorik kushton 1 lekë për litër.

Shitësi me pakicë i karburantit X nuk i njeh të ardhurat që rrjedhin nga shkëmbimi i karburantit motorik me shitësin me pakicë të karburantit Y – një shkëmbim mallrash apo shërbimesh të ngjashme. Shitësi me pakicë i karburantit X do t'i njohë të ardhurat kur t'ja shesë klientëve të tij karburantin e marrë në transaksionin e shkëmbimit.

Shembuj ilustrues për paragrafët 14 dhe 15

Shembulli 20

Një njësi ekonomike shet sisteme kulluese me çmim 450,000 lekë. Sipas kushteve të marrëveshjes së shitjes, çmimi i shitjes përfshin gjithashtu mirëmbajtjen e parë teknike të planifikuar për t'u kryer pas 6 muajsh. Çmimi i mirëmbajtjes teknike, nëse blihet më vete, është 12,000 lekë.

Meqënëse çmimi i shitjes përfshin dy komponentë të ndashëm dhe të identifikueshëm (shitjen e produktit dhe kryerjen e shërbimit) me afate të ndryshme realizimi, atëherë të ardhurat nga të dy komponentët njihen më vete.

1. Shitja e sistemeve kulluese:

D Kërkesa të arkëtueshme 450,000 lekë

K Të ardhura të shtyra 12,000 lekë

<p>K Të ardhurat nga shitja 438,000 lekë</p> <p>2. Njohja e të ardhurave për mirëmbajtjen teknike pas 6 muajsh:</p> <p>D Të ardhura të shtyra 12,000 lekë</p> <p>K Të ardhurat nga shitja 12,000 lekë</p> <p><u>Shembulli 21</u></p> <p>Kemi rastin e një marrëveshje të shitjes dhe riblerjes, sipas të ciles shitësi njëkohësisht bie dakord të riblejë të njëjtat mallra në një datë të mëvonshme, ose kur shitësi ka një opsion blerje për riblerjen, ose blerësi ka një kontratë me opsion që të kërkojë riblerjen nga ana e shitësit të mallrave. Për marrëveshje të shitjes dhe të riblerjes së një aktivi të ndryshëm nga një aktiv financiar, shitësi duhet të analizojë kushtet e marrëveshjes për të verifikuar nëse, në përmbajtje, rreziqet dhe përfitimet lidhur me pronësinë janë transferuar tek blerësi. Në qoftë se ato janë transferuar, shitësi i nje të ardhurat. Kur shitësi ka mbajtur rreziqet dhe përfitimet lidhur me pronësinë, edhe pse titulli ligjor është transferuar, transaksioni është një marrëveshje financiare dhe nuk krijon të ardhura. Për marrëveshjet e shitjes dhe të riblerjes së një aktivi financiar, zbatohen rregullat e çregjistrimit të SKK 7.</p>
<p><i>Shembuj ilustrues për paragrafët 16 deri 19</i></p>
<p><u>Shembulli 22 (kalimi i titullit ligjor)</u></p> <p>Njësia ekonomike A dhe njësia ekonomike B lidhin një marrëveshje shitjeje sipas të cilës titulli ligjor mbi një pajisje i kalon njësisë B në momentin e dorëzimit. PAGESA duhet të kryhet 30 ditë pas dorëzimit. Njësia ekonomike A nuk mban përgjegjësi për kryerjen e shërbimeve pas dorëzimit përveç atyre që diktohen nga kushtet dhe afatet e garancisë së pajisjes. Rrethanat e vetme në të cilat njësia B do të kishte mundësinë të mos t'a pranojë pajisjen janë vetëm ato kur pajisja nuk punon sipas karakteristikatve të deklaruara.</p> <p><i>Kur duhet të njihen të ardhurat?</i></p> <p>Të ardhurat duhet të njihen kur titulli ligjor mbi pajisjen i kalon njësisë ekonomike B. Kalimi i titullit përputhet me kalimin e rreziqeve dhe përfitimeve që lidhen me pronësinë. Njësia ekonomike A nuk ka mbajtur rreziqe të rëndësishme që lidhen me pronësinë dhe nuk ka detyrime të tjera për të përmbushur përveç atyre që përshkruhen në marrëveshjen e garancisë. Njësia ekonomike A duhet të njohë një detyrim për reklamimet e mundshme në bazë të përvojës së mëparshme si dhe faktorëve të tjerë.</p> <p><u>Shembulli 23 (shitja me montim)</u></p> <p>Njësia ekonomike C prodhon dhe monton antena satelitore për TV kabllor në ambientet e klientëve në emër të operatorit TV kabllor B. Më 1 gusht 2012 njësia ekonomike B ka bërë një porosi në njësinë ekonomike C për prodhimin dhe montimin e 100 antenave satelitore në ambientet e klientëve. Njësia ekonomike C i ka antenat gjendje dhe parashikon t'i instalojë ato brenda 14 shtatorit 2012. PAGESA do të kryhet 14 ditë pas instalimit të antenave. Njësia ekonomike C parashikon të përfundojë me sukses pjesën më të madhe të montimeve vetëm gjatë një vizitë tek secili klient.</p> <p><i>Në cilin moment duhet që njësia ekonomike C të njohë të ardhurat në shembullin e mësipërm?</i></p> <p>Njësia ekonomike C duhet të njohë të ardhurat kur të përfundojë montimi. Montimi është i rëndësishëm për pranimin e mallit dhe kryerjen e pagesës nga ana e njësisë ekonomike B. Shitja e mallrave shpesh konsiderohet e kryer nëse shoqërohet nga një montim i suksesshëm, dhe montimi shpesh është i rëndësishëm për funksionimin e mallrave të shitur.</p> <p><u>Shembulli 24 (shitja e mallrave me të drejtë kthimi)</u></p> <p>Njësia ekonomike A është shitës me pakicë. Ajo ndjek një politikë standarde sipas së cilës ajo rimbursen mallrat e kthyer, pavarësisht nga fakti nëse mallrat janë me defekte ose jo vetëm me kusht që ato të mos jenë përdorur. Njësia A shet 100 disqe muzikore me 120 lekë secila. Kostoja e njësisë A për një disk është 90 lekë.</p>

Zakonisht 10% e klientëve të njësisë A e kthejnë këtë lloj produkti.

Si do t'i kontabilizojë njësia A 100 disqet e shitur?

Drejtimesit e njësisë ekonomike A duhet të njohin të ardhurat nga shitja e mallrave por në të njëjtën kohë të bëjnë gjithashtu një rregullim për të pasqyruar mundësinë e kthimeve të mallrave të shitur. Drejtimesit duhet të njohin të ardhurat vetëm për 90% të disqeve të shitur të cilat ata nuk parashikojnë se do të kthehen nga klientët duke krijuar një provizion prej 10% të shumës së shitjeve për kthimet e mundshme. Regjistrimet kontabël për njohjen e të ardhurave dhe të provizionit do të jenë si më poshtë:

D Kërkesa të arkëtueshme / mjete monetare	12,000 lekë
K Të ardhura nga shitja [90% x 12,000]	10,800 lekë
K Provizioni për mallrat e kthyera [10% x 12,000]	1,200 lekë

Regjistrimet për njohjen e kalimit të mallrave tek klienti do të jenë si më poshtë:

D Kosto e mallrave të shitura	9,000 lekë
K Inventari	9,000 lekë

Kostoja e plotë e 100 disqeve shkarkohet nga inventari dhe përfshihet në koston e mallrave të shitura. Atëherë kur 10% e disqeve kthehen tek shitësi, do të bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:

D Inventari [10% x 9,000]	900 lekë
K Kosto e mallrave të shitura	900 lekë

Njësia ekonomike duhet të verifikojë gjithashtu, nëse produktet e kthyera janë të dëmtuara ose të dala jashtë përdorimit dhe nëse po, të bëjë zhvlerësimin e tyre. Mbajtja në inventar e produkteve të mundshme për reklamim nuk është e lejueshme pasi njësia A nuk ka më kontroll mbi këto aktive. Nga ana tjetër këto mallra nuk duhet të regjistrohen as si kërkesë e arkëtueshme pasi njësia A nuk e ka plotësisht të sigurt mundësinë e arkëtimit të parasë për këto produkte. Së fundmi, njësia ekonomike nuk e zvogëlon provizionin me koston e inventarit të parashikuar për kthim, sepse shuma e parashikuar e humbjes për njësinë ekonomike A, për shkak të kthimit të produkteve, është çmimi plotë i produktit.

Në momentin e rimbursimit të klientit që kthen disqet njësia ekonomike bën regjistrimin e mëposhtëm:

D Provizion	1,200 lekë
K Kërkesa të arkëtueshme / mjete monetare	1,200 lekë

Shembuj ilustrues për paragrafët 20 deri 23

Shembulli 25

Një inxhinier kalibrimi lidhi një kontratë për kalibrimin e makinës së një prodhuesi në intervale gjashtëmujore përgjatë një periudhe dyvjeçare që përfundon më 31 dhjetor 2012. Më 1 janar 2011 prodhuesi i pagoi inxhinierit të kalibrimit 10,000 lekë. Kostoja e inxhinierit të kalibrimit për të kryer çdo kalibrim është përafërsisht 1,000 lekë.

Inxhinieri i kalibrimit duhet të njohë të ardhura prej 2,500 lekë nga ofrimi i shërbimeve të kalibrimit, kur ai kryen shërbime kalibrimi në çdo muaj qershor 2011, dhjetor 2011, qershor 2012 dhe dhjetor 2012. Shërbimet e kalibrimit kryhen përmes një numri të paracaktuar veprimesh (katër kalibrime) në kohë të caktuara (intervale gjashtëmujore nga 1 janar 2011). Prandaj shuma e arkëtuar më 1 janar 2011 (10,000 lekë) njihet fillimisht nga inxhinieri i kalibrimit si detyrim.

Shembulli 26

Një njësi ekonomike i ofron shërbime mirëmbajtjeje një pale të tretë sipas një kontrate me çmim fiks prej 100,000 lekë. Njësia ekonomike vlerësoi fillimisht se kostot e saj totale sipas kontratës do të ishin 60,000 lekë. Në fund të periudhës raportuese (2011) njësia ekonomike ka kryer kosto prej 50,000 lekë dhe pret që të kryejë kosto të

mëtejshme prej 15,000 lekë për të përfunduar shërbimet e mirëmbajtjes. Njësia ekonomike e përcakton fazën e përfundimit të kontratës duke iu referuar pjesës që kostot e kryera për punën e realizuar deri në këtë datë përfaqësojnë në kostot totale të vlerësuara.
Në fund të vitit 2011 kontrata është 76.923 për qind e përfunduar - llogaritje: $50,000 \text{ lekë kosto të kryera} \div 65,000 \text{ lekë kostot totale të vlerësuara të kontratës}$. Prandaj, në vitin 2011 njësia ekonomike duhet të njohë të ardhurat prej 76,923 lekë - llogaritja: $76.923\% \times 100,000 \text{ lekë të ardhurat totale të pritshme}$. Përveç kësaj, njësia ekonomike duhet të njohë kostot prej 50,000 lekë.

Shembulli 27

Një firmë sigurimi lidh kontrata përmes të cilave ajo ofron shërbimet e sigurisë për pronarët e shtëpive në rast se bien sistemet e tyre të alarmit. Firma e sigurimit e ka mbylljen e vitit më 30 qershor. Më 1 janar 2011 pronari i një shtëpie i paguan firmës së sigurimit 10,000 lekë. Në këmbim të tarifës fikse, firma e sigurimit është e detyruar përmes kontratës t'i ofrojë shërbimet e ndërhyrjes së armatosur pronarit të shtëpisë për një periudhë dyvjeçare.

Firma e sigurimit duhet t'i njohë të ardhurat nga ofrimi i shërbimeve të ndërhyrjes së armatosur mbi një bazë lineare gjatë periudhës dy vjeçare (d.m.th. 417 lekë për muaj = 10,000 lekë të ardhura \div 24 muaj). Ndërhyrjet ndodhin vetëm kur alarmi bie në periudhën dyvjeçare të kontratës. Frekuenca dhe kohëzgjatja e këtyre ngjarjeve nuk mund të përcaktohet.

Për këtë arsye, të ardhurat do të njihen si më poshtë:

Viti i mbyllur në qershor 2011: $10,000 \text{ lekë} \times 6 \div 24 \text{ muaj} = 2,500 \text{ lekë}$.

Viti i mbyllur në qershor 2012: $10,000 \text{ lekë} \times 12 \div 24 \text{ muaj} = 5,000 \text{ lekë}$

Viti i mbyllur në qershor 2013: $10,000 \text{ lekë} \times 6 \div 24 \text{ muaj} = 2,500 \text{ lekë}$.

Shembulli 28

Një tregtar automjetesh lidh kontrata për të mirëmbajtur automjetet e reja të klientëve të tij për një periudhë trevjeçare. Më 1 janar 2011 një klient i pagoi tregtarit 10,000 lekë. Përvoja ka treguar se kostot e tregtarit për mirëmbajtjen e automjeteve të reja të modeleve në pronësi të klientëve janë mesatarisht 1,000 lekë në vitin e parë të pronësisë, 1,000 lekë në vitin e dytë dhe 3,000 lekë në vitin e tretë.

Mekaniku duhet t'i njohë të ardhurat nga ofrimi i shërbimeve të mirëmbajtjes së automjeteve për klientët si vijon: 2,000 lekë në 2011, 2,000 lekë në 2012 dhe 6,000 lekë në 2013. Edhe pse shërbimet e mirëmbajtjes së automjeteve kryhen përmes një numri të pacaktuar veprimesh gjatë një periudhe të caktuar kohore, përvoja jep evidenca se 20 përqind e punës do të kryhet në secilin prej viteve 1 dhe 2 dhe 60 përqind e punës do të kryhet në vitin e 3. Ky raport përfaqëson më së miri fazën e përfundimit dhe pasqyron pritshmërinë e një marzhi bruto të vazhdueshëm gjatë periudhës së kontratës).

Shembuj ilustrues për paragrafët 24 deri 27

Shembulli 29 (kontrata të ndara)

Njësia ekonomike A prodhon dhe shet programe kompjuterike. Shitja merr formën e një liçense për përdorimin e një programi për një periudhë të kufizuar kohe, dhe përfshin dhënie të asistencës teknike gjatë periudhës së liçensës. Gjithashtu, shitja përfshin një element të rëndësishëm, atë të përshtatjes së programit bazë sipas nevojave të klientit.

Gjatë periudhës së përshtatjes së programit, njësia ekonomike A do t'i tarifojë klientëve të saj një sërë tarifash. Përveç tarifave që aplikohen gjatë periudhës së përshtatjes, një tarifë shtesë aplikohet në fillim të periudhës së liçensës sapo përfundon përshtatja e programit dhe sapo klienti e ka pranuar paketën e programit. Asnjë shumë tjetër nuk është e pagueshme gjatë periudhës së liçensës as për përdorimin e programit e as për mirëmbajtjen e tij.

Drejtuesit e njësisë A kërkojnë të dijnë si do të njihen të ardhurat nga kontrata.

Njësia duhet të kontabilizojë përshtatjen, liçensimin dhe mirëmbajtjen si elementë më vete. Përshtatja e programit duhet të kontabilizohet me metodën e fazës së përfundimit, kurse tarifa për përdorimin e programit dhe mirëmbajtjen do të njihen në mënyrë lineare përgjatë periudhës së liçensës.

Ndarja e të ardhurave totale nga kontrata mes shërbimeve të përshtatjes, së drejtës për përdorim dhe mirëmbajtjes së programit duhet të bëhet në bazë të vlerës reale të

këtyre shërbimeve. Shpërndarja e të ardhurave mbi këtë bazë ka të ngjarë të ndryshojë nga shpërndarja mbi bazë të afateve të faturimit.

Shembulli 30 (kontratat e kombinuara)

Një kontraktor është në bisedime për lidhjen e dy kontratave me një klient të vetëm. Klienti ose duhet të pranojë të dy kontratat njëherësh ose t'i refuzojë ato. Kontrata e parë do të jetë për projektimin e një uzine kimike dhe tjetra për ndërtimin e kësaj uzine. Marzhi i planifikuar i fitimit në kontratën e projektimit është 20%, ndërsa në kontratën e ndërtimit të uzinës, 10%.

Si do të njihen të ardhurat nga kontratat?

Të dyja kontratat duhet të kontabilizohen si një kontratë e vetme, pasi kontratat u negociuan si një paketë e vetme; klienti duhet ose t'i pranojë ose t'i refuzojë të dyja; kontratat janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën dhe do të realizohen në vijimësi njëra pas tjetrës. Një marzh i përgjithshëm duhet të njihet në kontabilitet pasi puna kryhet në të dyja kontratat.

Shembulli 31

Sipas një kontrate ndërtimi, një kontraktor bie dakord që të lidhë një kontratë me një çmim fiks prej 2,000 lekë për të rinovuar kuzhinën e një apartamenti banimi. Vlerësimi fillestar i kontraktorit për kostot e kontratës më 1 shkurt 2011, data në të cilën është rënë dakord për kontratën, është 1,200 lekë. Kontraktori e ka mbylljen e vitit më 31 dhjetor. Çmimi i kontratës do të paguhet kontraktorit në përfundim të rinovimit. Rinovimi u përfundua më 31 korrik 2011 me një kosto prej 1,250 lekë (d.m.th. kostot aktuale të kryera sipas kontratës më 31 korrik 2011 janë 1,250 lekë).

Edhe pse kjo kontratë përmbush kriteret e përkufizimit të një kontrate ndërtimi, ndërtimi ndodh në një periudhë kontabël të vetme (duke supozuar se njësia ekonomike nuk përgatit pasqyra financiare të ndërmjetme). Për këtë arsye nuk është e nevojshme që të shpërndahen të ardhurat e kontratës dhe kostot e kontratës në periudha kontabël të ndryshme duke qenë se faza e përfundimit është zero për qind në fillim të periudhës kontabël dhe 100 për qind në fund të periudhës kontabël. Të ardhurat nga kontrata prej 2,000 lekë dhe kostot e kontratës prej 1,250 lekë regjistrohen në 2011.

Shembulli 32

Faktet janë të njëjta si në shembullin 31. Por, në këtë shembull, kontraktori e ka mbylljen e vitit më 30 qershor. Më 30 qershor 2011 kostot e kryera të kontratës për punën e realizuar deri në këtë datë janë 800 lekë dhe kontraktori vlerëson se kostot për të përfunduar kontratën do të jenë 400 lekë (d.m.th. kostot totale të kontratës do të jenë 1,200 lekë). Kontraktori e përcakton fazën e përfundimit të kontratës duke llogaritur pjesën që kostot e kryera të kontratës për punën e realizuar deri në këtë datë përfaqësojnë në kostot totale të kontratës të vlerësuara së fundmi.

Duke qenë se ndërtimi ndodh në dy periudha kontabël, llogaritjet e fazës së përfundimit duhet të kryhen për t'i shpërndarë të ardhurat e kontratës midis të dy periudhave kontabël. Kontraktori llogarit fazën e përfundimit si më poshtë:

Faza e përfundimit = kostot e kryera që lidhen më punën e realizuar deri në këtë datë ÷ kostot totale të vlerësuara.

Faza e përfundimit më 30 qershor 2011 = 66.67% (d.m.th. 800 lekë ÷ 1,200 lekë = 66.67%).

Për vitin e mbyllur më 30 qershor 2011 kontraktori duhet t'i njohë të ardhurat prej 1,333 lekë (= 2,000 lekë × 66.67%) dhe kostot prej 800 lekë për këtë kontratë.

Për vitin e mbyllur më 30 qershor 2012 kontraktori duhet t'i njohë të ardhurat prej 667 lekë (d.m.th. 2,000 lekë minus 1,333 lekë të njohura në periudhat e mëparshme) dhe kostot prej 450 lekë (d.m.th. 1,250 lekë minus 800 lekë të njohura në periudhat e mëparshme) për këtë kontratë.

Shembulli 33

Një njësia ekonomike iu dha një kontratë (me çmim fiks) prej 5,000,000 lekë nga një autoritet transporti për të ndërtuar një rrugë 1,000 km dhe një stadium sportiv. Njësia ekonomike paraqiti oferta të veçanta për ndërtimin e rrugës dhe të stadiumit. Ofertat u shqyrtuan në procese konkurruese tenderimi të veçanta. Ndërtimi i çdo aktivi duhet të trajtohet si një kontratë e veçantë ndërtimi duke qenë se kriteret përmbushen:

(a) janë paraqitur propozime të veçanta për rrugën dhe stadiumin;

(b) rruga dhe stadiumi iu nënshtruan negociatave të veçanta dhe njësia ekonomike dhe autoriteti i transportit ishin në gjendje të pranin një ofertë dhe të refuzonin

<p>tjetrën – kjo evidentohet nga ofertat e veçanta që u dhanë në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra; dhe (c) për të përgatitur ofertat e saj të veçanta, njësia ekonomike ka qenë në gjendje të ndajë kostot dhe për këtë arsye shpenzimet dhe të ardhurat e çdo aktivi mund të identifikohen. Çmimi fiks i kontratës prej 5,000,000 lekë është shuma e këtyre çmimeve.</p> <p><u>Shembulli 34</u> Një njësi ekonomike kontraktohet për projektimin dhe ndërtimin e një hekurudhe që do të kalojë përmes plantacioneve të drurit të pesë fermerëve dhe do të lidhet me sistemin më afërt kombëtar hekurudhor (projekti). Kushti i projektimit është që të optimizohet efikasiteti i transportit të lëndëve drusore nga tokat e fermerëve te sistemi kombëtar hekurudhor. Gjatësia e shinave në tokën e çdo fermeri mund të ndryshojë dhe nuk është domosdoshmërisht në proporcion me madhësinë e plantacioneve të fermerëve. Për sigurimin e projektit njësia ekonomike negocoi me fermerët në mënyrë kolektive. Por, kur fermerët ranë dakord që të lidhnin kontratën me njësinë ekonomike për të ndërmarrë projektin, u lidhën kontrata të veçanta me secilin prej fermerëve. Çdo fermer është i detyruar sipas kontratës që të paguajë njësinë ekonomike 100,000 lekë për projektimin dhe ndërtimin e pjesës së hekurudhës që do të ndërtohet në tokën e tyre. Njësia ekonomike duhet ta trajtojë grupin e kontratave me pesë fermerët si një kontratë të vetme ndërtimi: (a) grupi prej pesë kontratash u negociua si një paketë e vetme për projektimin dhe ndërtimin e një hekurudhe që kalon më mënyrë efektive përmes plantacioneve të pesë fermerëve; (b) kontratat janë aq ngushtë të ndërlidhura sa që ato janë, në fakt, pjesë e një projekti të vetëm me një marzh të përgjithshëm fitimi - hekurudha është projektuar dhe ndërtuar për efikasitet të përgjithshëm përmes plantacioneve të pesë fermerëve. Kostot që do të ketë toka e çdo fermeri nuk kanë asnjë ndikim në shumën fikse prej 100,000 lekë që çdo fermer duhet t'i paguajë njësisë ekonomike; dhe (c) kontratat realizohen në mënyrë të njëkohëshme ose në një rend të vazhdueshëm – ndërtimi i një hekurudhe që kalon përmes tokave të pesë fermerëve do të duhej domosdoshmërisht të projektohej njëkohësisht dhe të ndërtohej njëkohësisht ose në një rend të vazhdueshëm.</p>
<p><i>Shembuj ilustrues për paragrafët 28 deri 34</i></p>
<p><u>Shembulli 35 (humbja e pritshme në një kontratë ndërtimi)</u></p> <p>Njësia A po ndërton një ndërtesë për klientin e saj. Ndërtimi është aktualisht në vitin e dytë të një projekti trevjeçar. Drejtuesit e njësisë ekonomike kishin vlerësuar fillimisht që kontrata do të ishte me fitim dhe në vitin 1 njohu një fitim prej 20,000 lekë, në bazë të metodës së fazës së përfundimit. Në vitin 2 drejtuesit e njësisë ekonomike besojnë se kontrata do të ketë një humbje prej 30,000 lekë.</p> <p>Humbja duhet të llogaritet pas rishikimit të kostove të përlogaritura të përfundimit të kontratës, d.m.th. sa do t'i duhet njësisë të shpenzojë deri në përfundimin e projektit. Si rrjedhim, përderisa kjo ka të bëjë me një ndryshim në përlogaritje, njësia ekonomike duhet të regjistrojë humbjen nga kontrata në rezultatin e periudhës ushtrimore dhe jo të bëjë rregullimin në vitin e kaluar. Pra në vitin 2 duhet që të njihet humbja prej 30,000 lekë.</p> <p><u>Shembulli 36 (përcaktimi i të ardhurave në bazë të metodës së fazës së përfundimit)</u></p> <p>Një njësi ekonomike ka lidhur një kontratë me çmim fiks për ndërtimin e një ure për 9,000,000 lekë. Kostot e parashikuara të kontratës janë 8,000,000 lekë dhe periudha e ndërtimit është 3 vjet. Nga vlerësimi i kostove të projektit në fund të vitit të parë, u konstatua që kostot aktuale të urës mund të arrijnë shumën 8,500,000 lekë. Gjatë negociatave të kostos shtesë, klienti aprovon 9,200,000 lekë si çmim të ri kontrate. Kostot deri në fund të vitit të dytë përfshijnë 1,000,000 lekë që i takojnë materialeve që do të përdoren në vitin 3. Sipas llogaritjeve të bëra në fund të vitit 2, kostot totale të projektit do të jenë 8,700,000 lekë (Kostot faktive deri në fund të vitit 1 ishin 2,210,000 lekë dhe deri në fund të vitit 2 ishin 7,438,000 lekë). Në vitin 3 klienti aprovon shumën 9,250,000 lekë si çmim përfundimtar të kontratës. Kostoja aktuale e projektit rezulton të jetë 8,700,000 lekë.</p>

Më poshtë është dhënë një përmbledhje e të dhënave financiare që lidhen me projektin (në lek, në bazë kumulative):

	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Shuma fillestare e të ardhurave të miratuara në kontratë	9,000,000	9,000,000	9,000,000
Rregullimi i çmimit të kontratës	0	200,000	250,000
Të ardhurat totale të kontratës	9,000,000	9,200,000	9,250,000
Kostot e kontratës gjatë periudhës ushtrimore	2,210,000	5,228,000	1,262,000
Kostot kumulative të kontratës në datën e raportimit	2,210,000	7,438,000	8,700,000
-ku përfshihen shpenzimet e kryera që lidhen me materialet që do të shpenzohen në periudhën pasardhëse	0	(1,000,000)	0
Kostot kumulative të kontratës në datën e raportimit	2,210,000	6,438,000	8,700,000
Kostot tolate të parashikuara të kontratës	8,500,000	8,700,000	8,700,000
Përqindja e volumit të shërbimeve të kryera	26%	74%	100%
Të ardhurat kumulative të kontratës në datën e raportimit	2,340,000	6,808,000	9,250,000
-e cila përfshin të ardhurat gjatë periudhës ushtrimore	2,340,000	4,468,000	2,442,000

Në vitin 1, 2 dhe 3 të kontratës, njësia ekonomike e ka faturuar klientin për shumat 2,700,000 lekë, 1,100,000 lekë dhe 5,450,000 lekë, përkatësisht. Nga këto fatura, kërkesat e arkëtueshme janë 700,000 lekë, 400,000 lekë dhe 250,000 lekë, përkatësisht në fund të vitit 1, 2 dhe 3.

Aktivët, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e kontratës regjistrohen në librat kontabël të njësisë si më poshtë:

Pasqyra e pozicionit financiar

Aktivët

	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Kërkesat e arkëtueshme (faturat e lëshuara dhe të paguara)	700,000	400,000	250,000
Kërkesat e arkëtueshme (të ardhurat e njohura dhe të pafaturuara)	0	3,008,000	0
Inventaret	0	1,000,000	0

Detyrimet

Detyrimet për t'u paguar (të ardhurat e panjohura dhe të faturuara)	360,000	0	0
---	---------	---	---

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Shitjet neto	2,340,000	4,468,000	2,442,000
Kostoja e mallrave të shitura	2,210,000	4,228,000	2,262,000
Fitimi bruto	130,000	240,000	180,000

Kërkesat e arkëtueshme / detyrimet për t'u paguar llogariten si më poshtë:

	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Shitjet neto (në bazë kumulative)	2,340,000	6,808,000	9,250,000
Faturat e lëshuara (në bazë kumulative)	2,700,000	3,800,000	9,250,000

Kërkesat e arkëtueshme (të ardhurat e njohura dhe të pafaturuara)	0	3,008,000	0
Detyrimet për t'u paguar (të ardhurat e panjohura dhe të faturuara)	360,000	0	0

Shembulli 37 (njohja e një humbje të parashikuar)

Një agjenci reklamash lidh një kontratë me çmim fiks për një fushatë reklame dyvjeçare me një kosto totale prej 850,000 lekë. Kostoja e parashikuar e kontratës është 780,000 lekë. Gjatë përllogaritjes së kostove në fund të vitit 1, konstatohet se kostot aktuale të projektit mund të jenë ndoshta 120,000 lekë më shumë. Klienti nuk dëshiron të paguajë kostot shtesë. Në vitin 2 do të lëshohet një faturë për shërbimin e kryer.

Më poshtë jepet një përmbledhje e të dhënave financiare që lidhen me projektin (në lek, në bazë kumulative):

	Viti 1	Viti 2
Çmimi i kontratës	850,000	850,000
Kostot kumulative të kontratës në datën e raportimit	378,000	900,000
Kostot e përllogaritura të kontratës	900,000	900,000
Përqindja e volumit të shërbimeve të kryera	42%	100%
Humbja e parashikuar	50,000	50,000
Të ardhurat kumulative të kontratës në datën e raportimit	328,000	850,000

Meqënëse pritet që në fund të vitit 1 shpenzimet e kryera do të tejkalojnë të ardhurat nga këto shërbime me 50,000 lekë, në bazë të metodës së fazës së përfundimit nuk njihen të ardhura nga kontrata, ndërsa humbja e parashikuar njihet e tëra dhe menjëherë (shitjet neto = 378,000 – 50,000).

D. Kërkesat e arkëtueshme	328,000 lekë
K. Shitjet neto	328,000 lekë

Shembulli 38 (rezultati i një kontrate nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme)

Një kontraktor ndërtimi lidh një kontratë me çmim fiks prej 100,000 lekë për të ndërtuar një ndërtesë sipas një projektimi që nuk është bërë kurrë më parë dhe duke përdorur materiale që nuk janë përdorur asnjëherë më parë për ndërtimin e një ndërtese (projekti). Kontraktori e filloi ndërtimin e ndërtesës në vitin 2011 dhe pret që ndërtimi të zgjasë të paktën pesë vjet. Në vitin 2011 kontraktori pati 5,000 lekë kosto kontrate për këtë projekt. Në fund të vitit 2011 kontraktori nuk mund ta vlerësojë rezultatin e kontratës me besueshmëri të mjaftueshme për vlerësimin e përqindjes së përfundimit të projektit (p.sh. për shkak të pasigurive që rrjedhin nga projektimi i ri dhe materialet e reja njësisia ekonomike nuk mund t'i vlerësojë kostot totale të pritshme të kontratës me besueshmëri të mjaftueshme). Me shumë gjasa çmimi i kontratës do të merret nga klienti.

Në fund të vitit 2011 kontraktori duhet t'i njohë të ardhurat vetëm në shkallën e kostove të kryera të rikuperueshme të kontratës (d.m.th. 5,000 lekë të ardhura nga kontrata dhe 5,000 lekë shpenzime).

Shembulli 39 (arkëtimi i të ardhurave të njohura të kontratës nuk është më i mundur)

Shoqëria A ka lidhur një kontratë me fitim të pritshëm për ndërtimin e një objekti. Departamenti i Kontabiliteti të shoqërisë ka njohur një të ardhur prej 80,000 lekë nga kontrata e ndërtimit.

<p>Si rrjedhje e përkeqësimit të situatës së likuiditetit të klientit të saj e për pasojë dhe e paaftësisë së tij paguese, në fund të vitit financiar, shoqëria A ka vlerësuar se këto të ardhura të njohura nuk janë më të rekuverueshme. Shoqëria A ka vlerësuar se ky projekt tashmë është me humbje e se humbja që rrjedh nga kjo kontratë ndërtimi është 100,000 lekë.</p> <p>Në rastin në fjalë, pra kur arkëtimi i një shumë të njohur tashmë si e ardhur nga kontrata e ndërtimit, shoqëria nuk duhet të bëjë rregullim të të ardhurës por duhet të rregullojë shumën e paarkëtueshme.</p> <p>Shoqëria A duhet të njohë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve një shpenzim të barabartë me 180,000 lekë e cila do të kompensojë të ardhurën e njohur paraprakisht dhe do të çojë në një rezultat të barabartë me humbjen e pritshme nga kontrata, pra 100,000 lekë.</p> <p>Regjistrimet kontabël</p> <p>Njohja e të ardhurës</p> <table border="0"> <tr> <td>D. Llogari të arkëtueshme</td> <td>80,000 lekë</td> </tr> <tr> <td>K. Të ardhura nga shitja</td> <td>80,000 lekë</td> </tr> </table> <p>Regjistrimi i mosarkëtimit</p> <table border="0"> <tr> <td>D Shpenzime borxhi i keq</td> <td>80,000 lekë</td> </tr> <tr> <td>K Zbritje nga llogaritë e arkëtueshme</td> <td>80,000 lekë</td> </tr> </table> <p>Njohja e humbjes për periudhën kur ajo ndodh</p> <table border="0"> <tr> <td>D Shpenzime periudhe</td> <td>100,000 lekë</td> </tr> <tr> <td>K Detyrime</td> <td>100,000 lekë</td> </tr> </table>	D. Llogari të arkëtueshme	80,000 lekë	K. Të ardhura nga shitja	80,000 lekë	D Shpenzime borxhi i keq	80,000 lekë	K Zbritje nga llogaritë e arkëtueshme	80,000 lekë	D Shpenzime periudhe	100,000 lekë	K Detyrime	100,000 lekë
D. Llogari të arkëtueshme	80,000 lekë											
K. Të ardhura nga shitja	80,000 lekë											
D Shpenzime borxhi i keq	80,000 lekë											
K Zbritje nga llogaritë e arkëtueshme	80,000 lekë											
D Shpenzime periudhe	100,000 lekë											
K Detyrime	100,000 lekë											
<p><i>Shembuj ilustrues për paragrafët 40 deri 43</i></p>												
<p><i>Shpenzimet direkte që përfshihen në koston e ndërtimit</i></p> <p>Në rastin e një kontrate ndërtimi, shpenzimet që lidhen direkt me kryerjen e shërbimeve përfshijnë:</p> <ol style="list-style-type: none"> pagat e punëtorëve të ndërtimit; shpenzimet e materialeve të ndërtimit; amortizimin e aktiveve afatgjata materiale të përdorura në ndërtim; shpenzimet e transportit të pajisjeve dhe materialeve; shpenzimet e pajisjeve të marra me qira për ndërtim; shpenzimet e projektimit dhe të asistencës teknike; kostot e parashikuara të garancisë; shpenzimet e projektimit dhe të asistencës teknike, që lidhet direkt me kontratën e ndërtimit; kërkesat për zhdëmtim nga palët e treta. <p><i>Shpenzimet e përgjithshme që përfshihen në koston e shërbimit</i></p> <p>Shembuj të shpenzimeve të përgjithshme, që kanë të bëjnë me kontratat e shërbimeve, janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> sigurimet; shpenzimet e projektimit dhe të asistencës teknike, që nuk lidhen direkt me kryerjen e një shërbimi specifik; Shpenzime të tilla shpërndahen midis shërbimeve në mënyrë sistematike dhe racionale, si dhe në përputhje me qëllimin normal të aktivitetit. 												

	<p><i>Shpenzimet që nuk përfshihen në koston e shërbimit</i></p> <p>Shembuj të shpenzimeve të tilla janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) shpenzimet e administrimit të përgjithshëm, rimbursimi i të cilave nuk specifikohet në kontratë; (b) shpenzimet e marketingut dhe të shitjes; (c) shpenzimet e kërkimeve dhe zhvillimit, rimbursimi i të cilave nuk specifikohet në kontratë; (d) amortizimi i aktiveve afatgjata materiale që nuk përdoren për kryerjen e shërbimeve.
	<p><i>Shembuj ilustrues për paragrafët 44 dhe 45</i></p>
	<p><i>Shembulli 40 (dividendët)</i></p> <p>Gjatë vitit që u mbyll më 31 dhjetor 2011, njësi ekonomike A bëri një investim në njësinë ekonomike B. Më 31 dhjetor 2011, drejtuesit e njësisë ekonomike B deklaruan një dividend përfundimtar prej 0.15 lekë për aksion. Aksionerët e miratuan këtë dividend përfundimtar në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme vjetore të mbajtur më 31 janar 2012. Dividendi u pagua më 31 mars 2012.</p> <p><i>Kur duhet të njohë të ardhura njësi ekonomike A?</i></p> <p>Drejtuesit e njësisë ekonomike A nuk duhet të njohin të ardhura nga dividendi në periudhën ushtrimore që përfundon më 31 dhjetor 2011. Deklarata e drejtuesve të njësisë ekonomike B për dividendin është e mjaftueshme për të vendosur të drejtën e njësisë ekonomike A për marrjen e dividendit. Megjithatë, njësi ekonomike A nuk ka të drejtë të marrë dividendin deri sa ai të miratohet nga aksionerët.</p>
	<p><i>Shembuj ilustrues për paragrafët 46 deri 49</i></p>
	<p>Shembuj ilustrues në lidhje me paraqitjen e të ardhurave dhe shënimet përkatëse shpjeguese jepen në Pasqyrat Financiare Ilustruese tek SKK 2.</p>